

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7361 E mërkurë 22 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion i Ditës

**P**ër politikanët, diplomatët dhe këdo që ka ndjekur në vazhdimësi politikën dhe median gjermane, largimi i liberalëve të FDP-së nga tryeza e bisedimeve ...  
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE

**Tërmet politik edhe për Evropën**



## Opinion i Ditës

**Z**onja dhe zotërinj, ju falënderoj për rritesën tuaj dhe ndihem shumë i lumtur dhe i nderuar të jem mes një auditori kaq të veçantë e të nderuar, shkrimtarësh ...  
Vijon në faqen 22

Nga ILIR META

**Dita e Alfabetit shqip, moment përbashkues i kombit**



Dosja "Habilaj", 40 vetë nën hetim

## Hetim pasuror për ish-shoferin e Tahirit, Caka: Çfarë më lidh me to

Biseda e Ramës me Finon për ish-ministrin: Gjetja e patentës nuk implikon njeri

Nis hetimi pasuror për Gentian Cekën, shoferin e ish-ministrin të Brendshëm, Saimir Tahiri. Prokuroria e Krimeve të Rënda ka vendosur të verifikohen asetet pasurore dhe llogaritë bankare të shtetasit Ceka. Sipas burimeve, verifikimi do të kryhet nga grupi i prokurorëve që kanë nën hetim prej ...  
Në faqet 2-3

## ZYRTARIZOHEN ÇMIMET E REJA PER FURNIZIMIN ME UJE NE TIRANE DHE RRETHE

# TARIFA E RE PER UJIN, SA DO PAGUAJNE FAMILJET E BIZNESI

Tabela e re sipas vendimit të Entit Rregullator të Ujit. Si ndryshon pagesa për qytetarët dhe kush përfiton nga falja, si do arkëtohen



(Në foto) Çezmë uji (foto ilustruese)

### ZBARDHEN SUGJERIMET

**Dokumenti, ikën Llalla, si do të zgjidhet kryeprokurori i ri**  
Në faqen 4

### INDEKSIMI

**Rritja e pensioneve, si do shpërndahet fondi 490 ml lekë për përfituesit**  
Në faqen 7

### TARIFAT E VENDOSURA

**Udhëzimi i ri: Të regjistrohen diplomat e arsimit të lartë, procedura**  
Në faqen 18

### "VIP PAGES"

**Rudina Dembacaj: Xhelozia seksi e burrit tim... Marrëdhënia me Aliajn**  
Suplement

### RISI NE SISTEM



**Kolegji Universitar "Luarasi" çel dy mastera të rinj profesionale**  
Në faqen 17


Publikohet dokumenti i 21 nëntorit 1947, i Gjykatës Ushtarake të Elbasanit

## Myftar Grabocka: Vdekje për Edip Tërshanën, Konomin e Alimerkon

*"Të pandehurit kanë qenë të lidhur me organizatën terroriste PD e Balli"*

Nga DASHNOR KALOÇI & SPARTAK TOPOLLAJ

A shtu siç theksuam edhe në një nga shkrimet e para pak ditëve, të botuara ekskluzivisht në faqet e "Gazeta Shqiptare", (referuar një dokumenti arkivor të vitit 1970-të), që me ardhjen e tij në



pushtet në fundin e nëntorit të vitit 1944, e deri në fundin e 1990-ës, regjimi komunist i Tiranës filloi dhe vijoi në mënyrë lineare, goditjet me arrestime, burgime, ekzekutime dhe internime ndaj të ashtuquajturave grupe armiqësore, të cilat ...  
Në faqet 10-11

# ÇESHTJA 'TAHIRI' HETIMI

**Collomb: Mes 2 vendeve ka një bashkëpunim të shkëlqyer**

## Fatmir Xhafaj takon homologun në Paris, Franca mbështet Shqipërinë

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj zhvilloi një takim në Francë me homologun francez Gérard Collomb në një atmosferë të plotë besimi dhe mbështetjeje. Xhafaj në një postim në "Twitter" shprehet se takimi në Paris është zhvilluar në një atmosferë të plotë besimi. "Atmosferë e plotë besimi dhe mbështetjeje në takimin që sapo zhvillova në Paris me homologun dhe mikun francez, ministrin e Brendshëm, Gérard Collomb". Gjithashtu, ministri francez thotë se mes dy vendeve ka një bashkëpunim të shkëlqyer. "Jemi shumë të kënaqur nga zhvillimet pozitive që nga takimi ynë i fundit në korrik. Faleminderit për bashkëpunimin e shkëlqyer të vendosur mes nesh!". Sakaq, më herët në një prononcim për median, ministri i Brendshëm, Xhafaj ka reaguar në lidhje me procesin e vetingut në polici. Ai është shprehur se



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

synon që së bashku me asistencën ndërkombëtare, procesi i vetingut të mund të përmbillet brenda këtij viti. "Siç është bërë e njohur, vetingu është në procesin e hartimit të kuadrit ligjor.

Besoj se shumë shpejt ju do të njiheni me dokumentin dhe analizën dhe me planin e veprimet. Dhe gradualisht ne do të kalojmë tek aktet rregullatorë, me synimin me shpresën, së bashku me asistencën ndërkombëtare që kemi angazhuar për këtë proces, të mund ta përmbylim brenda këtij viti", tha ministri i Brendshëm, Xhafaj. Gjithashtu, Xhafaj ka theksuar se është e vështirë të përcaktohet se sa efektivë policie apo drejtorë policie do t'i largohen organizatës së policisë në kuadër të vetingut.



Patentat e Saimir Tahirit të sekuestruara nga policia

Dosja "Habilaj", përkthehen 1800 faqe përgjime, 40 persona nën hetim

# Nis hetimi pasuror ndaj shoferit të ish-ministrit Tahiri

## Gentian Ceka: Patentat i lashë unë në makinën e Orest Sotës

Nis hetimi pasuror për Gentian Cekën, shoferin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Prokuroria e Krimeve të Rënda ka vendosur të verifikohen asetet pasurore dhe logaritë bankare të shtetasit Ceka. Sipas burimeve, verifikimi do të kryhet nga grupi i prokurorëve që kanë nën hetim prej muajit tetor dosjen "Habilaj-Tahiri", që gjithashtu është nën hetim pasuror edhe ish-ministri i Brendshëm së bashku me të afërmit e tij. Nga përgjimet e realizuara në telefonin e Orest Sotës, shfaqet edhe biseda e tij me shoferin Gentian Ceka. Gjithashtu, Ceka është marrë në pyetje pasditen e së hënës në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Ai ka dhënë sqarime lidhur me 2 patentat e lundrimit të Saimir Tahirit, të cilat u gjetën në makinën e Orest Sotës së bashku me 863 mijë euro. Sipas tij, Sota nuk ka lidhje me këtë histori dhe se është faji i tij që i ka lënë në kroskotin e automjetit. Prokurorët nuk japin detaje se çfarë dyshimesh kanë për përfshirjen e Gentian Cekës në listën e të hetuarve, në një kohë që ai ka shpëjuar se patentat e ish-ministrit i



Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri

**DËSHMIA**

Gentian Ceka është marrë në pyetje pasditen e së hënës në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Ai ka dhënë sqarime lidhur me 2 patentat e lundrimit të Saimir Tahirit, të cilat u gjetën në makinën e Orest Sotës së bashku me 863 mijë euro.

kishte marrë në Durrës dhe i kishte harruar në kroskotin e makinës dy muaj më parë. Ndërsa grupi hetimor gjatë kësaj jave ka marrë dëshmitë e disa personave të tjerë për çështjen "Tahiri-Habilaj", ndër ta edhe oficerë policie. Por, emrat e tyre nuk

bëhen të ditur për shkak të sekretit hetimor. Ndërkohë, për biznesmenët Sota, Krimeve të Rënda po verifikojnë edhe tenderat e fituara nga kompanitë e tyre gjatë viteve, përfshirë edhe rikonstruksionin e komisaratiit të Kombinatit. Sakaq,

prokurorët e Krimeve të Rënda janë duke kryer veprime konkrete për dosjen "Habilaj", pas përkthimit të saj nga Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu, nën hetim janë rreth 40 persona, ndër të cilët edhe ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, raporton "ABC News". Fillimisht dosja ka kaluar në Prokurorinë e Përgjithshme, ku në total janë 1800 faqe të cikluara. Më herët Gjykata e Katanas kishte lënë në masë sigurie arrest me burg, Moisi Habilaj, i cili u arrestua nga akuzat si kreu i grupit kriminal. Për të njëjtën dosje qëndron pas hekurave në vendin tonë, financieri i Habilajve, Nezar Seitaj dhe Armando Koçerit. Këtu të fundit iu gjetën në banesën e tij në Babicë të Vlorës rreth 4 tonë kanabis. Ndërkohë, vijon të jetë në kërkim edhe vëllai tjetër i Moisiut, Florian Habilaj. Gjithashtu, në dokumentet e përkthyer gjenden edhe shumë udhëtime me automjetin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, të cilin ua kishte shitur me herët familjarëve të Habilajve. Mësohet se nga përgjimet e kryera, deputeti Tahiri kishte udhëtuar gjashtë herë jashtë vendit me "Audi A8".



## 863 mijë euro, Gjykata e Apelit Durrës lë në burg Orest Sotën

DURRES - Gjykata e Krimeve të Rënda do të shqyrtojë çështjen gjyqësore në ngarkim të biznesmenit Orest Sota, të cilit iu gjetën në makinë 863 mijë euro dhe patentat e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Gjykata e Apelit në Durrës ka vendosur të delegojë te Gjykata e Krimeve të Rënda çështjen e Orest Sotës, për të cilin ka dy hetime. Ai akuzohet për fshehje të të ardhurave, drejtimi i mjetit pa patentë dhe mosbindje ndaj policisë. Gjykata e Apelit në Durrës nuk e pranoi ankimmimin e përfaqësuesit ligjor të Sotës, duke shpallur moskompetencë për këtë çështje gjyqësore. Përfaqësuesi ligjor i Orest Sotës, i cili mungonte në seancën e mbajtur sot në Durrës, kërkoi gjykimin e klientit të tij në gjendje të lirë, por ankimmimi nuk u mor për bazë. Prokurori i çështjes kërkoi që të transferohej çështja drejt Krimeve të Rënda, gjykatë e cila një ditë më parë vendosi "arrest me burg" për Sotën në rivlerësimin e masës së sigurisë.





**Xhaçka, mes ushtarakëve në mision**

Rama, trupave në Afganistan:  
Ajo çka bëni nuk ka të paguar

Mesazhe mirënjohje dhe falënderimi i drejtë kryeministri Edi Rama kontingjentit të ushtarakëve të Forcave tona të Armatosura në kuadër të misionit të NATO-s në Afganistan, teksa komunikoi dje në një lidhje të drejtpërdrejtë me ta në vend-diskimin e tyre në Kabul, ku ndodhej edhe ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka. "Jemi mbledhur këtu, bashkë me një pjesë të miqve dhe aleatëve, me të cilët trupat shqiptare kontribuojnë këtu në Afganistan. Kemi marrë vlerësimet maksimale për përkushtimin dhe profesionalizmin e ushtarakëve tanë", - u shpreh Ministrja Xhaçka, duke theksuar gjithashtu se shërbimi i tyre nuk është vetëm në dobi të Afganistanit, por i shërben edhe stabilitetit dhe projektimit të sigurisë për të gjithë zonën euroatlantike. "Kam marrë shërbimin para 11 muajsh dhe dëshiroj t'u informoj se performanca e trupave tanë në Afganistan është e jashtëzakonshme. Kam pasur rastin të takoj komandantët e të gjitha niveleve, të cilët kanë shprehur vlerësimet e tyre maksimale për punën e personelit tonë", - tha një nga drejtuesit e kontingjentit në Kabul. Duke i falënderuar për kontributin e çmuar për sigurinë dhe performancën e lartë në detyrë, kryeministri siguroi se mbështetja e qeverisë ndaj tyre do të vijë duke u rritur. "Jemi shumë mirënjohës dhe shumë krenarë për këtë. Jam unë që duhet t'u falënderoj. Ne përpigemi të bëjmë më të mirën. Sigurisht do të donim të bënim më shumë dhe më shumë do të bëjmë hap pas hapi, se mundësitë janë reformave dhe përpjekjeve të përbashkëta shkojnë duke u rritur, jo duke u zvogëluar. Por, fakti është që ajo çka ju bëni, nuk ka të paguar, - siç thotë populli, - për dinjitetin e vendit tonë dhe për nderin e flamurit tonë", u shpreh Rama.

Kryeministri mbledh deputetët e Komisionit të Ligjeve në Kryeministri

# Biseda me Finon për Tahirin, Rama: Gjetja e patentës diku nuk implikon njeri

PS, gati plani për shkarkimin e Zgurit më 30 nëntor

Kryeministri Edi Rama thirrri dje në një takim të posaçëm në Kryeministri deputetët socialistë të Komisionit parlamentar të Ligjeve. Pjesë e këtij komisioni në fakt është edhe Saimir Tahiri, por ai nuk ka qenë i pranishëm, për faktin se tashmë është i pezulluar nga të gjitha funksionet në PS dhe në grupin parlamentar deri në përfundim të hetimeve. Burimet nga takimi bëjnë me dije se në një bisedë të lirë ka qenë deputeti Bashkim Fino, ai që i ka shprehur kryeministrit Rama shqetësimin për situatën në të cilën ndodhet ish-ministri Saimir Tahiri. Madje, Fino mësohet se i ka thënë kryeministrit se Tahiri ishte mjaft i shqetësuar, veçanërisht pas gjetjes së patentave në makinën e biznesmenit O.S. Sipas "Report.TV", kryeministri Edi Rama i ka pohuar Finos se Tahiri nuk ka pse shqetësohet, sa i përket çështjes së patentave që u gjetën në makinën e Orest Sotës. Rama mësohet se i është përgjigjur se çdokush mund t'i harrojë patentat në makinën e një tjetër personi. Dy patentat të ish-ministrit Saimir Tahiri u gjetën në makinën e biznesmenit Orest Sota, ku u sekuestruan edhe 863 mijë euro. Ndërkohë, ky hetim është duke vijuar dhe po pyetet edhe shoferi i ish-ministrit, për të cilin është thënë se ka qenë ai, personi që i ka marrur patentat në makinën. Gjithsesi, takimi mes Ramës e deputetëve ka vijuar me çështjen e tjera, për të cilat deputetët janë thirrur dje zyrtarisht. Kështu, temë e bisedës mësohet se ka qenë çështja e zgjedhjes së kryeprokurorit të ri të republikës. Më 4 dhjetor përfundon edhe mandati i kryeprokurorit Llalla dhe sipas Kushtetutës dhe interpretimit të bërë, ai do të largohet. Sipas reformës në drejtësi, të drejtën për hapjen e procedurës dhe dërgimit në Kuvend të një liste me kandidatët për prokurorë të përgjithshëm e ka Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili ende nuk është themeluar. Mësohet se mazhoranca është në kërkim të emrave për të zëvendësuar Llallën deri në zgjedhjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ndërkohë, një çështje tjetër, të cilën PS do ta "zgjidhë" javën që vjen është edhe shkarkimi i kryetarit të KQZ-së, Klement Zguri, të cilit veç mandatit



Kryeministri Edi Rama, gjatë një mbledhjeje të Grupit të PS

**SEANCA**  
Kërkesa për shkarkimin e Zgurit u firmos nga deputetët socialistë javën që shkoi dhe u depozitua në Kuvend. Tashmë pritet që në seancën e datës 30 nëntor ajo të diskutohet fillimisht në Konferencën e Kryetarëve dhe më pas në fillim të seancës, ku në fakt do të duhet të kalojë nën për nen buxheti i shtetit për vitin 2018.

**Kryetarja e LSI paralajmëron protesta masive popullore**

## Kryemadhi: Rrezikojmë rikthimin e '97, shqiptarët po humbin shpresën

LSI ngriti dje shqetësimin se vendi po shkon drejt përsëritjes së një viti tjetër '97. Në një deklaratë të saj, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi u shpreh: "Faktikisht Rama nuk kontrollon asgjë, por Rama kontrollon nga krimi i organizuar. Unë e kam thënë dhe e përsëris që është telekomanda, një instrument në dorën e kriminit të organizuar, i cili përdor institucionet shqiptare për të arritur qëllimin e tyre". Duke kujtuar atë çfarë ndodhi me zgjedhjet e 1996 dhe më pas situatën kaotike të 1997, Kryemadhi u pyet në një intervistë në "syri.net" se a rrezikon vendi një tjetër vit të tillë. Ajo u shpreh: "Absolutisht në atë situatë është, vetëm gjërat mund të jenë në ngjyra të ndryshme, pra mund të jetë një realitet i njëjtë për atë çka ndodh përsa i përket varfërisë së



shqiptarëve. Në qoftë se në '96-'97 shqiptarët humbën kursimet e tyre, tashmë po humbasin shpresën, sepse kursime s'kanë më. Sepse gjatë gjithë kësaj kohe varfëria është instaluar dhe po rikthehet në një institucion zyrtar në Shqipëri, por tashmë në qoftë se në '97 shqiptarët humbën kursimet, këtu shqiptarët po humbasin shpresën". Kryemadhi paralajmëroi edhe protesta

**PETRIT VASILI**  
Kryetari i grupit të LSI-së deklaroi dje: "Kryeministër, vrite frikën dhe fol për 2 miliardë euro që rrezikon Shqipëria, nuk ta kemi borxh një tjetër '97. Shqipëria rrezikon të paguajë rreth 2 miliardë euro për prishjen e disa kontratave. Është e barabartë me pasojat që shqiptarët provuan deri në palcë me rënien e piramidave financiare në 1997".  
popullore. "Sigurisht që nuk është zgjuar akoma, sepse njerëzit janë shumë të varfër; por edhe të lodhur, edhe të neveritur nga politika. Do vijë një moment që nuk do durojë më dhe do shpërthejë, por do doja që ky reagim agresiv që do vijë nga shqiptarët, të mos bjerë mbi institucionet, por mbi njerëzit që e kanë shkaktuar atë gjë", tha Kryemadhi.

të kryetarit, do t'i heqin edhe atë të anëtarit të KQZ-së. Kërkesa për shkarkimin e Zgurit u firmos nga deputetët socialistë javën që shkoi dhe u depozitua në Kuvend. Tashmë pritet që në seancën e datës 30 nëntor, ajo të diskutohet fillimisht

në Konferencën e Kryetarëve dhe më pas në fillim të seancës, ku në fakt do të duhet të kalojë nën për nen buxheti i shtetit për vitin 2018. Më pas, Kuvendi do të hapë procedurat për vendin vakant. Nuk dihet ende se cili do të jetë emri i ri që do

të mbështetet nga Partia Socialiste për të zëvendësuar Zgurin. Me këtë lëvizje, PS siguron shumicën në Komisionin Zgjedhor të Zgjedhjeve, duke i dhënë fund marrëveshjes së nënshkruar me PD-në më 18 maj.

# KRYEPROKURORI MANDATI

3 dhjetori, në mungesë të KLP-së, prokuror i përkohshëm me shumicë të thjeshtë

## Dokumenti, ikën Llalla, si do të zgjidhet kryeprokurori i ri

Zbardhen sugjerimet e EURALIUS dhe OPDAT

Valentina Madani

Mandatin e kryeprokurorit aktual, Adriatik Llalla, nuk mund ta zgjasë asnjë autoritet kushtetues pas skadimit. Bëhet fjalë për datën 3 dhjetor, kohë kur përfundon mandati i z.Llalla dhe Kuvendi duhet të zgjedhë një kryeprokuror të përkohshëm deri në zgjedhjen e Këshillit të Prokurorisë. OPDAT dhe EURALIUS kanë dhënë opinion për këtë çështje, duke theksuar se nuk ka organ në vend që mund të zgjasë mandatin e kryeprokurorit. GSH.al ka siguruar dokumentin me sugjerimet konkrete për mënyrën se si duhet të veprojë. Sipas tyre ekziston një dispozitë e qartë që vendin e Llallës ta zërr një prokuror i përkohshëm që zgjidhet me shumicë të thjeshtë. Për zgjedhjen e tij në Kuvend do të duhet të jenë gjysma e deputetëve. OPDAT dhe Euralius shprehet se "Mandati i kryeprokurorit përfundon në fillim të dhjetorit dhe përgjegjësi për emërimin e kryeprokurorit të ri është KLP, një organ që ende nuk është krijuar. Në këto kushte, ekziston një dispozitë, propozohet të emërohet një kryeprokuror i përkohshëm derisa të ngrihet KLP. Për zgjedhjen e tij në Kuvend do të duhet të jenë gjysma e deputetëve". "Në situatën që paraqitet këtu, duket se dispozitat kalimtare përcaktojnë të drejtën dhe detyrimin e Kuvendit të zgjedhë një prokuror të lartë, i cili i plotëson kërkesat e neneve 22 deri 27 të ligjit, si prokuror i përkohshëm me shumicë të thjeshtë, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Nuk ka autoritet kushtetues ose ligjor për parlamentin që të zgjasë mandatin e Prokurorit të Përgjithshëm aktual, mbas skadimit të mandatit të tij. Përkundrazi, ekziston një dispozitë e qartë që urdhëron emërimin e një Prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm", theksohet qartë në rekomandimet e OPDAT dhe Euralius. "Zgjedhja e një prokurori, i cili është emëruar që të kryejë funksionet e



Kryeprokurori Adriatik Llalla

**Note**  
**Election of a prosecutor who is assigned the functions of Prosecutor General in the transitory period**  
 The mandate of the incumbent Prosecutor General ends in early December. The High Prosecutorial Council, which is in charge of nominating the Prosecutor General, is not yet established. Therefore, the transitory regime for the election of the temporary acting General Prosecutor applies. Legal framework for the transitory period:  
 Article 179 paragraph 13 of the Constitution reads:  
 'Until the Parliamentary elections, which will be held after the entry into force of this law, but not later than 1 September 2017, the election of the High Justice Inspector and the Prosecutor General, shall be made by 2/3 of the members of the Assembly. Other elections shall be made by 3/5 of the members of the Assembly.'  
 The question arises whether the provision of other elections relate to the election of other candidates for constitutional bodies in the period until 1 September 2017, or the election of other candidates for constitutional bodies in whatever time period.  
 The Constitution provides for several constitutional bodies which are to be elected by the Assembly a specific quorum, for example:  
 • Article 125 paragraph 2 determines a quorum of 3/5 for Constitutional Court judges who are elected by the Assembly.  
 Article 127 paragraph 2 determines a quorum of 2/3 for the members of the High Justice Inspectorate.

### Vetingu, KPK: Hetojmë faktet implikuese nga qytetarët

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të një dekreti bëri dje të ditur se qytetarët pas ankesave të shumta që këta të fundit kanë adresuar për KPK-në. Mësohet se sipas tyre kjo strukturë nuk do të rishqyrtojë vendimet gjyqësore, dhe nuk do të merret as me rihapje të proceseve duke nënvizuar se denoncimet e qytetarëve do të merren parasysh vetëm gjatë rivlerësimit të figurave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ndërkohë KPK i ka bërë thirrje qytetarëve që të dërgojnë fakte implikuese, duke u siguruar një hetim mbi informacionet e sjella. "Sqarojmë se ky komision është një institucion i rëndësishëm i ligjit të vetingut, në hallkat e të cilit pritet të kalojnë pasuritë e zyrtarëve të akuzuar për korrupsion, ku shënjestër janë prokurorët dhe gjyqtarët", thuhet në njoftimin e KPK-së.

një prokuror të përgjithshëm në një periudhë tranzitore. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm në detyrë përfundon në fillim të dhjetorit. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i cili është përgjegjës për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm ende nuk është

themeluar. Prandaj, zbatohet regjimi kalimtar (transitor) për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm". Më tej rekomandohet: "Pas renditjes edhe të të gjithë kuadrut të ri ligjor, por edhe të parashikimit kushtetues, në këtë rast misioni i BE dhe

### ZGJEDHJA

Sipas nenit 109 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë", në rast se mandati i prokurorit përfundon para kohe, para themelimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, funksionet e prokurorit do të caktohen me vendim të asamblesë përkohësisht nga një nga prokurorët më me përvojë nga radhët e prokurorëve që plotësojnë kërkesat dhe kriteret e Kapitullit IV, Seksioni I të këtij ligji".



### MANDATI

Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm në detyrë përfundon në fillim të dhjetorit. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i cili është përgjegjës për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm ende nuk është themeluar, prandaj, zbatohet regjimi kalimtar (transitor) për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm.

## Integrimi i Shqipërisë në BE

### Balla: Alternativa për një demokraci të qëndrueshme

Kryetari i Grupit Parlamentar të PS, Taulant Balla, nga Komiteti i Punëve të Jashtme të Parlamentit Europian që po mbahet në Bruksel, deklaroi dje se anëtarësi në BE është interesi më i madh popullit shqiptar. Po ashtu, Balla theksoi se integrimi i plotë i Shqipërisë në familjen europiane konsiderohet si alternativa e vetme dhe më e mirë për një demokraci të qëndrueshme. Mes të tjerash kreu i Grupit Parlamentar të PS risolli në vëmendje marrëveshjen e 17 majit, duke shtuar faktin se konsolidimi i mëtejshëm i dialogut politik mes shumicës parlamentare dhe opozitës vazhdon të mbetet prioritet i parlamentit shqiptar. "Duke folur përmes



votës, qytetarët shqiptarë e kanë thënë qartë se kjo është ajo që ata dëshirojnë. Zbatimi i reformës më të fortë në drejtësi midis vendeve të tjera të Ballkanit, e cila shërben si shembull për t'u ndjekur, po ecën përpara. Rezultatet e para të procesit të

### DIALOGU

"Konsolidimi i mëtejshëm i dialogut politik dhe konstruktiv mes shumicës parlamentare dhe opozitës vazhdon të mbetet prioritet i parlamentit shqiptar", - tha Balla.

verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve do të publikohen së shpejti. Ne besojmë në mbështetjen tuaj për të kaluar në fazën tjetër të procesit të anëtarësimit të plotë në familjen evropiane", deklaroi z.Balla.

SHBA arrin në konkluzionin se me mbarimin e mandatit të Llallës i hapet rrugë zgjedhjes së kryeprokurorit të përkohshëm, por që plotëson kriteret e parashikuara në ligj. Në situatën që paraqitet këtu, duket se dispozitat kalimtare përcaktojnë të

drejtën dhe detyrimin e Kuvendit të zgjedhë një prokuror të lartë, i cili i plotëson kërkesat e neneve 22 deri 27 të ligjit, si prokuror i përkohshëm me shumicë të thjeshtë, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Nuk ka autoritet kushtetues

ose ligjor për parlamentin që të zgjasë mandatin e Prokurorit të Përgjithshëm aktual, mbas skadimit të mandatit të tij. Përkundrazi, ekziston një dispozitë e qartë që urdhëron emërimin e një Prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm".





"Statut të ri për PD", Harxhi: Përzgjedhja e kandidatëve të nisë nga baza

# Përçahen kritikët e Bashës, dy grupe me propozime të ndryshme

*Ndryshimet statutoare, Patozi: S'kam lidhje me to*

Valentina Madani

Kritikët e kreut të PD-së, Lulzim Basha, kanë pësuar 'krisjen' e parë pas gjendjes së vështirë të krijuar në PD si rezultat i humbjes së thellë të 25 qershorit. Dy anëtarët e Këshillit Kombëtar të PD-së, Edvin Kulluri dhe Edit Harxhi i dorëzuan dje z.Basha propozime konkrete për ndryshimin e statutit. Por, grupi anti-Basha i krijuar pas marrëveshjes së 18 majit, i kryesuar nga ish-nënkryetari i PD, Astrit Patozi dhe ku u bashkuan disa figura të njohura në PD, siç ishin Besnik Mustafai, Majlinda Bregu, Ridvan Bode etj., nuk kanë asnjë lidhje me grupin "Harxhi".



**EDIT HARXHI**

"Iniciativa për ndryshime statutoare për bashkimin dhe ringritjen e PD. Ndryshimet për ristrukturimin strukturave të PD kufizojnë pushtetin e kryetarit dhe zvogëlimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar. Të kufizohet numri i anëtarëve të Kuvendit kombëtar të PD", tha Harxhi.

**ASTRIT PATOZI**

"Për shkak të keqkuptimeve të krijuara, qëllimisht ose pa dashje dhe të shumë lajmeve për këtë çështje, që shoqërohen me foton time, jam i detyruar të sqaroj se as e kam lexuar dhe as kam lidhje me atë tekst. Jemi në një fazë më të avancuar të aksionit politik", tha Patozi.

**Krimi, Rama letër 28 kryeministrave**

## Berisha: Dhurata e vetme e Ramës për BE-në

Pas letrës së dërguar kryeministrave evropianë nga kryeministri Rama dy ditë më parë, reagoi ish-kryeministri Berisha, i cili akuzon kryeministrin se e vetmja dhuratë që Rama ka për Bashkimin Europian është krimi dhe droga e Shqipërisë. Berisha shkruan nja postim të gjatë në "Facebook" se: "Me këtë deklaratë në letrën e tij, ai kërkonte t'i bënte ata bashkëfajtorë dhe bashkëpërgjegjës për lumin e drogës dhe krimin të organizuar që eksportohet nga Shqipëria në vendet e tyre. Kjo është një vetë-akuzë edhe më e rëndë se e para, që Noriega bën me shkrim para 28 liderëve të vendeve anëtare të BE". Sipas Berishës: "Përpjekja e Ramës për të bërë bashkëpërgjegjës kryeministrat e vendeve anëtare të BE për



**DOSSJA**

Ish-kryeministri Berisha tha dje se EULEX-i ka një dosje jo vetëm për Vangjush Dakon, por edhe për Edi Ramën. "Në dosjet e regjistrimit të EULEX-it, Gjushi është gjurma, ndërsa ujku është Rama", shprehet ai duke theksuar se ky i fundit është në regjistrimet e EULEX.

shndërrimin e Shqipërisë në Kanabistan është thjesht një përpjekje banditeske, tragjike dhe e stilit të vjetër hoxhiste. Kjo deklaratë vetëm sa i bën kryeministrat e vendeve anëtare të BE dhe qeveritë e tyre të jenë më të vendosur në qëndrimet ndaj Shqipërisë dhe të konsiderojnë masa shtrenguese konkrete ndaj vendit tonë për kërcënimin që paraqet eksporti i drogës dhe krimin nga Sh-

qipëria për rendin dhe sigurinë e tyre". Berisha shprehet se këto nisma tashmë kanë filluar dhe ato do të vazhdojnë. "Duke përfunduar, u bëj thirrje të gjithë atyre shqiptarëve që të ardhmen e tyre e besojnë jashtë krimin dhe drogës, të marrin përgjegjësitë tona dhe të ngrihemi në një revolucion popullor për të përmbysur Noriegën dhe narko-shtetin e tij", shprehet z.Berisha.



## PD, Paloka: Rama mbron Dakon, i jep pushtet krimin

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka, akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se po hesht ndaj asaj që kjo forcë politike e ka denoncuar si skandal, përgjimin e kryebashkiakut të Durrësit, Vagjush Dako, ku pretendohet se ka bërë pazare për të blerë vota. Paloka tha se për Dakon po heton Prokuroria e Krimeve të Rënda, institucion që sipas Partisë Demokratike disponon dhe përgjimin. "Marrja nën kontroll e prokurorisë dhe sistemit të drejtësisë e bën Vangjush Dakon të ndjehet i paprekshëm", deklaroi ai. "Rama u jep mbrojtje politike të inkriminuarve - tha Paloka, pasi siç deklaroi ai - ç'do aferë të çon tek emri i tij". "Edi Rama po e trajton kryetarin e Bashkisë së Durrësit njësoj si Saimir Tahirin. Po i jep mbrojtje politike nga drejtësia, sepse gjithçka dhe të gjithë lidhen me Edi Ramën. Me Edi Ramën lidhet krimi nëpërmjet Saimir Tahirit, Qazim Sejditit, Vangjush Dakos, Agron Xhafajt", u shpreh z.Paloka. Ai bëri të qartë se vetëm me largimin e Ramës, do të ketë garanci për luftën ndaj krimin.

brenda PD-së. Patozi shprehet se nuk e paragjykon nismën, sepse çdo anëtar i PD-së ka të drejtën të paraqesë idetë që ndihmojnë PD-në të ringritet. Sipas tij, është më e rëndësishme ringritja e PD-së, ndërsa ndryshimi statutorë do t'i lihet në dorë Bashës. "Përsa më takon, mund të them se ne jemi në një fazë shumë më të avancuar të aksionit tonë politik, pa shpalljes së platformës politike, e cila prej kohësh është në dispozicion të publikut dhe të forumeve të PD. Unë nuk kam besuar për asnjë sekondë se dëshitimet e Lulzim Bashës er-

**SHPJEGIMI**

Ish-nënkryetari i PD-së, Astrit Patozi, shpjegoi dje në "Facebook" lidhur me projektin për ndryshimet statutoare, që sipas shtypit do t'i paraqiten Lulzim Bashës si zgjidhje për krizën politike

Intervista/Presidenti: Hetim ndërkombëtar për rastin e Kumanovës

# Vizat e kosovarëve, Meta: Shtetësia shqiptare, lëvizje joproductive

## "Partia ime e vetme tashmë është Kushtetuta"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta sqaroi dje gjatë një interviste për radion "Evropa e Lirë" se e ka mirëkuptuar kërkesën e Presidentit kosovar, Hashim Thaçi për pajisjen me pasaporta të qytetarëve kosovarë, por kjo nuk do të ishte zgjidhje për lehtësimin e lëvizjes së tyre në zonën Shengen. "Do të ishte një lëvizje joproductive, një lëvizje joracionale dhe nga e cila jo vetëm që qytetarët e Kosovës që nuk do të përfitonin, por mund të dëmtoheshin edhe ata të Shqipërisë", u shpreh Presidenti Meta. I pyetur se çfarë nënkupton kur ka sugjeruar më shumë transparencë në hetimin për ngjarjet e Kumanovës, Presidenti shqiptar tha: "Besoj që angazhimi i faktorit ndërkombëtar do të ishte një veprim pozitiv për rritje e transparencës në fazat e tjera të gjykimin të kësaj çështjeje dhe për të garantuar një drejtësi të standardeve evropiane larg çdo lloj paragjykimi apo qëndrimi që krijon mosbesim". Ndërkohë, gjatë një interviste për programin "200" të Nazim Rashidit në televizionin "Alsat" të Maqedonisë, kreu i shtetit deklaroi se partia e tij e vetme, tashmë është Kushtetuta. Sa i përket kandidaturës së tij si president, Ilir Meta deklaroi se ai ishte kandidati më i mirë, pasi Partia Demokratike ndodhej në çadër; në protestë, në bulevard.

**Fillimisht dua të ndalem te roli që ka Shqipëria si shtet në rajon. Në kohën kur Serbia luan një rol aktiv për mbrojtjen e interesave të serbëve kudo që ndodhen, në këtë kontekst, cili është roli i Shqipërisë kundrejt interesave të shqiptarëve?**

Besoj se Shqipëria ka një rol tepër pozitiv për gjithë shembullin dhe përkushtimin e saj për forcimin e marrëdhënieve me fqinjët dhe bashkëpunimin rajonal si një shtyllë e fortë e gjithë e filozofisë dhe angazhimit të saj për evropianizimin e këtij rajoni. Dhe natyrisht që në këtë drejtim dhe në këtë koncept, ajo ka qenë e përkushtuar dhe e angazhuar për të inkurajuar dhe për të përkrahur shqiptarët kudo në rajon, që të fitojnë të drejtat e tyre në varësi dhe me gjendjen në rajon në raportin ku ata janë ndodhur dhe janë si qytetarë të Evropës, ku duam të anëtarësohemi të gjithë.

**Në këtë drejtim do të dua të ndalem dhe në atë se si shihni në ngritjen e çështjes së pasaportave që ka kërkuar Presidenti Thaçi për qytetarët e Kosovës, si kundërpërgjigje BE-së, karshi liberalizimit të vizave?**

E kam mirëkuptuar kërkesën publike të Presidentit Thaçi si një apel për një zgjidhje sa më të shpejtë të çështjes së liberalizimit të vizave dhe jo si një alternativë reale për tejkalimin e këtij ngërçi apo izolimi të qytetarëve të Kosovës nga një proces ku janë përfshirë të gjitha vendet e rajonit prej kohësh. Sepse jo vetëm që nuk është e drejtë që qytetarët e Kosovës të vazhdojnë të kenë pengesë, por njëkohësisht besoj se marrja e shtetësisë shqiptare nuk do të ishte asnjë zgjidhje për të lehtësuar lëvizjen e tyre drejt vendeve të zonës Shengen për arsye se vetë Shqipëria është një vend i detyruar të tregojë kujdes të vazhdueshëm sa u takon të gjitha detyrimeve që burojnë nga zbatimi i liberalizimit të vizave.

Pra, do të ishte një lëvizje joproductive, një lëvizje joracionale dhe nga e cila jo vetëm që qytetarët e Kosovës që nuk do të përfitonin, por mund të dëmtoheshin edhe ata të Shqipërisë. Kështu që besoj se ky qëndrim është një mesazh për një sensibilizim më të madh edhe ndërkombëtar, besoj edhe evropian për t'i dhënë zgjidhje kësaj çështjeje, e cila sikurse e dimë, është lidhur prej disa kohësh me një çështje tjetër, që është ajo e zgjidhjes së demarkacionit me Malin e Zi. Unë besoj dhe uroj se pas përfundimit të zgjedhjeve vendore në Kosovë, qeveria e re e Kosovës në bashkëpunim edhe me opozitën



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, dje gjatë një interviste për radion "Evropa e Lirë"

## Kreu i shtetit takon krerët e partive shqiptare dhe Gruevskin

Presidenti Ilir Meta u takua dje me krerët e partive politike shqiptare në Maqedoni dhe me kreun e VMRO-DPMNE, Presidenti Meta u takua me kryetarin e BDI-së, Ali Ahmeti; me kreun e BESA-s, Bilal Kasami; me kryetarin e Aleancës për Shqiptarët, Zijadin Sela si dhe me kreun e PDSH-së, Menduh Thaçi. Gjatë këtyre takimeve Presidenti Meta vuri në dukje dhe theksoi rolin kyç të faktorit politik shqiptar për harmoninë ndëretnike në Maqedoni, si dhe nënvizoi rëndësinë që mbart bashkëpunimi dhe dialogu konstruktiv i të gjitha forcave politike për ardhmërinë dhe perspektivën integruese euro-atlantike të Maqedonisë.

Presidenti Meta theksoi rëndësinë që ka bashkëpunimi i të gjithë faktorëve politikë në Maqedoni për integrimet euroatlantike dhe sigurinë rajonale. Gjithashtu, Presidenti i Republikës zhvilloi një takim të veçantë edhe me kryetarin e



opozitës maqedonase (VMRO-DPMNE), Nikolla Gruevski, gjatë të cilit theksoi rëndësinë që ka roli i opozitës në të gjitha proceset euro-integruese të Maqedonisë. Në kuadër të vizitës zyrtare, Presidenti i Republikës, Ilir Meta nderoi kujtimin e Shenjtores Nënë Tereza, duke vendosur një buqetë me lule te monumenti i saj në Shkup, si dhe duke vizituar shtëpinë e lindjes së humanistes shqiptare me famë botërore.

të gjejë bashkëpunim për të ecur përpara dhe për të zgjidhur jo vetëm çështjen e demarkacionit përfundimshëm me Malin e Zi, por edhe për të pasur mundësinë për të përfunduar nga liberalizimi i vizave të gjithë qytetarët e Kosovës.

**Z. President, në deklaratën tuaj pas takimit që kishit me Presidentin e Maqedonisë, Ivanov, ju keni inkurajuar autoritetet e Maqedonisë për hetim dhe proces gjyqësor transparent për ngjarjet që lidhen me Kumanovën, nënkupton kjo edhe angazhimin e faktorit ndërkombëtar? Çfarë nënkuptoni kur thoni se duhet më shumë transparencë?**

Pa diskutim që vlerësoj edhe angazhimin e faktorit ndërkombëtar, që reformën në drejtësi dhe performancën e institucioneve të drejtësisë e ka në qendër të vëmendjes. Besoj që angazhimi i faktorit ndërkombëtar do të ishte një veprim pozitiv për rritjen e transparencës në fazat e tjera të gjykimin të kësaj çështjeje dhe për të garantuar një drejtësi të standardeve evropiane larg çdo lloj paragjykimi apo qëndrimi që krijon mosbesim.

**Z. President, vizita e juaj përkon me festën e alfabetit, ndërkohë që në Parlamentin e Maqedonisë zhvillohet debat rreth ligjit që rregullon përdorimin zyrtar të**

shqipes. Në njëër anë kemi ekspertët që thonë se shqipja mbetet lag gjuhës maqedonase sa i përket zyrtarizimit të saj dhe faktori politik shqiptar, që është pjesë e qeverisë, që thotë se me këtë ligj shqipja zyrtarizohet në të gjitha institucionet. Si e shihni ju këtë çështje?

Unë besoj se çështja e ligjit të gjuhëve është në proces, ne kemi diskutuar edhe me autoritetet maqedonase edhe me të gjithë drejtuesit e forcave politike shqiptare këtu, po kështu në këtë drejtim ka edhe një angazhim të faktorit ndërkombëtar, pra është një proces më kompleks. Kemi marrë garanci edhe nga përfaqësuesit e forcave politike shqiptare, jo vetëm ata që janë në qeveri, por edhe ata në opozitë se do të bëjnë më të mirën për të arritur maksimumin në këtë drejtim dhe shpresoj që në fund të kemi një legjislacion, i cili sjell një arritje pozitive dhe shumë të pritur për të gjithë qytetarët shqiptarë të Maqedonisë.

**Gjatë kësaj vizite në Shkup e keni vënë theksin mbi rëndësinë e integritetit të Maqedonisë në NATO dhe BE, duke shprehur mbështetje për rezervat të shtetit shqiptar në këtë drejtim, për t'i dhënë shtytje Maqedonia këtij procesi. Ju gjithashtu takuat edhe liderin e opozitës maqedonase VMRO DPMNE-së, Nikolla Gruevski, i cili shihet si personaliteti që i ka dhënë hapësirë influencës ruse gjatë kohës kur ai qeveriste me shtetin si kryeministër...**

Unë besoj se stabiliteti dhe siguria e Maqedonisë paraqet stabilitet edhe për Shqipërinë dhe për të gjithë rajonin dhe në këtë kontekst, besoj se tre apo katër muajt e ardhshëm janë vendimtarë për të zgjidhur një çështje të mbartur gati prej një dekade. Dhe unë jam më optimist, do të thosha si asnjëherë më parë, për mundësinë e realizimit të kësaj arritjeje historike. Të gjitha forcat politike shqiptare janë të angazhuara në këtë drejtim dhe i kuptojnë se sa e rëndësishme është që Maqedonia të jetë anëtare e NATO-s, por edhe që Maqedonia të zhbllokojë proceset e integritetit evropian. Këto dy kolona të forta do të mund të realizojnë edhe ato deficite që shqiptarët ndiejnë këtu në Maqedoni, sa u takon të drejtave dhe realizimit të një barazie të plotë, por shpresoj që edhe vetë opozita maqedonase të kontribuojë në këtë drejtim, pavarësisht rrugëve të ndryshme që ajo mendon, pasi edhe ajo është e përcaktuar për anëtarësimin në NATO dhe për anëtarësimin në BE, ndërkohë që qeveria aktuale dhe kryeministri i ri janë tepër të vendosur për të bërë çdo gjë sa i përket arritjes së këtyre objektivave sa më shpejt.

**Ju shpreheni me tone shumë optimiste se Maqedonia mund të bëjë kthesa shumë të mëdha sa i përket anëtarësimin në NATO, ku e mbështesni këtë optimizëm?**

Po, jam më optimist se asnjëherë më parë. Po, këtë optimizëm e mbështes të situata në Maqedoni, angazhimi dhe përkushtimi i Maqedonisë dhe i qeverisë së Maqedonisë nuk kanë qenë asnjëherë në këto nivele që janë sot. Të gjitha forcat politike shqiptare janë qartësisht për t'i shërbyer këtij prioriteti, por besoj dhe shpresoj se edhe opozita maqedonase të këtë një qasje sa më konstruktive dhe bashkëpunuese që të jetë e mundur në këtë drejtim. Pra, ka një tërësi faktorësh që mund të sjellin një produkt pozitiv dhe të preksëm si asnjëherë më parë.



Indeksimi i pensioneve, fondi për vitin 2018 arrin në 1.8 miliardë lekë

Ornela Manjani

# Rritja e pensioneve, ja si shpërndahet fondi për përfituesit

## Fondi për nxitjen e punësimit arrin në vlerën e 490 milionë lekë

Pensionistët do të përfitojnë rritje pensionesh në masën 2-3%. Fondi i vënë në dispozicion në buxhetin e vitit 2018, i cili po diskutohet nënën në komisionet parlamentare arrin në rreth 1.8 miliardë lekë. Rritje përfitimesh është parashikuar për pensionet familjare, pensionin social, pensionin e pleqërisë dhe personat që përfitojnë të ardhura nga aksidente në punë dhe pagesat e invaliditetit

### KOMISIONI

Fondi i indeksimit të pensioneve për vitin 2018 do të jetë në vlerën e një miliard e 820 milionë lekëve. Sipas raportimeve të Ministrisë së Financave pranë Komisionit të Shëndetësisë dhe të Çështjeve Sociale, fondi i nxitjes së punësimit nuk do të ketë ndryshim nga ai i një viti më parë. Ky fond do të jetë në vlerën e 490 milionë lekëve. "Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar në vlerën 1 miliardë e 820 milionë lekë. Këtu doja t'i referohesha ligjit 7703 dhe konkretisht nënën për indeksimin e përfitimeve, ku shprehimisht thuhet se pensioni social, pensionet e pleqërisë, ato të invaliditetit, pensionet familjare si dhe të ardhurat nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale indeksohen çdo vit për të kompensuar pasojat e ndryshimeve të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve të zgjedhura, për nivelin minimal të jetesës së pensionistëve", thonë specialistët e MF në komision. Referuar pretendimeve të sindikatave



Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla

në vend për rritjen e pagës minimale pritet që të diskutohet në mbledhjen e radhës së Këshillit të Punës. Nga sindikata është propozuar që të ketë një rritje të pagës minimale me 30%, e cila do të shkojë nga 240 mijë në 280 mijë lekë.

### MOSHA E PENSIONIT

Nërkohë mosha e daljes në pension për burrat dhe gratë në vitin 2018. Mosha e daljes në pension për gratë do të jetë 60 vite e 8 muaj dhe për burrat 65 vite. Aktualisht për vitin 2017, mosha e daljes në pension sipas nenit 43, për gratë është 60 vite e

6 muaj (rritet për çdo vit me 2 muaj deri në vitin 2056 që arrin në 67 vjeç) dhe për burrat 65 vjeç (mosha fillon rritet që nga viti 2033 me nga 1 muaj në vit për të arritur në 67 vjeç në vitin 2056). Ndërsa vjetërsia e plotë kontributive për të dy gjinitë është 35 vite e 8 muaj, e cila rritet me 4 muaj në vit, për të arritur me 40 vite në vitin 2029. Për llogaritjen e pensionit të pleqërisë sipas ligjit 104/2014, neni 18, i cili ndryshon nënin 32 të ligjit 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet si

më poshtë: 1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. 2. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit që ka realizuar personi me periudhën e sigurimit të kërkuar sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social. 3. Shtesa do të jetë 1% për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogarit sipas nenit 31 të ligjit 104/2014 (i cili ndryshon nënin 59 të ligjit 7703, datë 11.05.1993).

## Nikolla: Nga klasa e 5-të deri në 12-ën, tekstet falas

Nxënësit e shkollave nga klasa e pestë deri në klasën e dymbëdhjetë do të vijojnë të përfitojnë tekste falas. Kështu deklaroi ministria e Arsimit Lindita Nikolla gjatë prezantimit të buxhetit në Komisionin parlamentar të Ekonomisë. Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla, u shpreh se do të ketë mbështetje financiare për një kategori të zgjeruar nxënësish për përfitimin e librave falas. Pas kërkesës së deputetes së PD, Jorida Tabaku për ndërtimin e shkollave me PPP në bashkinë e Tiranës, Nikolla iu përgjigj: "Në vitin 2018 buxheti i shtetit nuk alokon fonde për këtë investim. Nuk është deri në klasën e nëntë, është deri në klasën e dymbëdhjetë. Kështu ka qenë për të gjithë kategoritë e tjera që përfitojnë tekste falas. Ishin gjashtë kategori në 2013 u shtuan edhe shtatë të tjera pas 2013 për të gjithë këto nxënës. Pra, nga klasa e pestë deri në klasën e dymbëdhjetë do të vijojnë të përfitojnë tekste falas, madje në një mënyrë të re, duke iu hequr barrën prindërve që një herë të parapagojnë pastaj të marrin subvencionin, por duke i marrë falas, duke monitoruar punën në shkollë, Drejtoria Arsimore, Ministria e Arsimit në mënyrë që fëmijëve t'ju shkojnë tekstet falas." Buxheti për arsimin në 2018 është parashikuar në vlerën e 38.3 miliardë lekë, ndërkohe që për 2017 fondet e dhëna janë 36.3 miliardë lekë. Ndërtimi i shkollave përmes kontratave me PPP nuk duhet të ndodhë në një kohë që qytetarët paguajnë taksë për infrastrukturën shkollore në kryeqytet, ku parashikohen këto projekte. Ky ka qenë qëndrimi i nënkryetares së Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku, ku po diskutoheshin koncesionet për vitin e ardhshëm.

## Ministri: PPP për rrugët, skemë e qëndrueshme

### Gjignuri: Kriza energjetike mund të rrezikojë buxhetin

Ministri Infrastruktura dhe Energjisë, Damian Gjignuri tha dje se zgjatja e krizës së prodhimit të energjisë mund të rrezikojë buxhetin e 2018. "I vetmja rrezik që kemi është ulja e prodhimit të energjisë me vazhdimin e thatësirës, gjë që ne nuk e parashikojmë. Është i vetmi kërcënim që unë dua ta thërras, pasi nuk ka gjë për të fshehur, pasi kemi pasur 1,4 terra/vat prodhim më pak për shkakt të thatësirës, e cila bën që Shqipëria të jetë e ekspozuar ndaj importeve", u shpreh ai. Buxheti nuk parashikon fonde të drejtpërdrejta për blerjen e energjisë, por do të ndiqet situata hap pas hapi se si do të operojë

OSHEE. "Nëse do të vazhdojë kriza do të shikojmë mënyrën sesi do të financohet ky gap", deklaroi Gjignuri. Ministri i Energjetikës dhe Infrastruktura, Damian Gjignuri mbrojtë buxhetin dhe planin e qeverisë për të dhënë me anë të partneritetit publik-privat një vend rrugësh kryesore në vend. Gjignuri tha para Komisionit të Ekonomisë se buxheti nuk ka mundësi që të financojë projekte madhore, por që me skemën PPP mund të realizohen. "Rruga e investimeve me anë të PPP është më e qëndrueshme dhe projektet përfundojnë në kohë. Ne nuk i kemi mundësitë për të financuar rrugët nga buxheti i shtetit dhe me variantin e PPP, do të bëhen vetëm nyjat kryesore kombëtare",



u shpreh ai. Gjignuri njoftoi, gjithashtu, edhe kryerjen e një auditit sa i takon investimit në rrugën Tiranë-Elbasan. "Projekti ka probleme serioze dhe shembull tipik i rrugomanisë. Duam që rruga të përfundojë sa më parë, por edhe të dalin përgjegjësitë", u shpreh ai. Gjignuri tha, gjithashtu, se do të kryhet një verifikim dhe më pas anulim i të gjitha licencave të transportit ndërqytetas të dhëna në mënyrë abuzive.

## KORRIDORI BLU

### Takimi, nis puna për fizibilitetin e autostradës Adriatiko-Joniane

Shqipëria dhe Mali i Zi kanë nisur punën e tyre për një studim paraprak fizibilitetit, lidhur me autostradën Adriatiko-Joniane, një nga projektet më të rëndësishme që lidhen me detyrat e SEETO-s dhe konektivitetin. Gjatë vizitës zyrtare në Podgoricë, ministri i Infrastruktura dhe Energjisë Damian Gjignuri zhvilloi bisedime bilaterale me ministrin e Transportit dhe Marinës Osman Nurkovic dhe ministrin e Ekonomisë Dragica Sekulic ku u dhanë edhe detaje për këtë projekt. Nga studimi pritet kryerja e një analize të detajuar mbi investimin e mundshëm, prioritetet e ndërhyrjes, me qëllim bër-



jen e një projekti financiarisht të mundshëm për t'u mbështetur. "Diskutuan më lidhje me projektet e infrastrukturës rrugore ku të dyja vendet kanë si projekt prioritet autostradën Adriatiko-Joniane. Kemi marrë financimet e nevojshme për të bërë studimin përfundimtar të fizibilitetit. U njoha edhe me projektet e zhvillimeve infrastrukturorë në Malin e Zi që ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në

lidhjen me Shqipërinë. Ngërta problemet që kërkojnë vëmendjen e palës malazeze për kompletimin e rrugëve të tjera dytësore që lidhin pika të tjera kufitare me Shqipërinë", theksoi ministri Gjignuri. Autostrada Adriatiko-Joniane apo Korridori Blu është autostrada e të ardhmes që zgjatet përgjatë gjithë bregut lindor të Adriatikut dhe detit Jon duke u zgjatur deri në pjesën perëndimorë të Gadishullit të Ballkanit. Rruga nis nga Trieste në Itali, kalon përmes Sllovenisë, hyn në Kroaci afër Rijekës dhe det Trebinjë në Bosnjë përpara se të hyjë në Mal të Zi. Gjithsesi ende nuk janë konkluduar projektet finale.

## Investimet e huaja direkte, Kombet e Bashkuara "Shqipëria, keq me incentivat në taksa dhe tatimfitimin e dividendit"

Shqipëria është i vetmi vend në rajon që "vuan për incentiva në taksa, në funksion të rritjes së investimeve të huaja direkte. Një analizë e fundit e konferencës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Tregtisë dhe Këshillit Rajonal për Bashkëpunim, të titulluar "Vlerësimi i politikave të investimeve në Europën Juglindore" jep detaje. Në seksionin që ndalet vetëm tek "Taksimi" thuhet se në raport me vendet e tjera, ne kemi sistem taksash më penalizues në nivel. Në këtë kontekst, raportin i referohet vendimit të qeverisë për të rritur tatimfitimin në 15 për qind nga 10 për qind që ishte në

vitin 2013, si dhe pjesës së taksimit më të lartë të dividendit. Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi, Republika e Moldavisë, Serbia, Maqedonia, Kosova të gjitha kanë ose një situatë mesatare ose më favorizuese se Shqipëria. Tek treguesit e tjerë ku merren parasysh kompleksiteti i sistemit, Shqipëria ka regjistruar një situatë pozitive, ashtu sikurse ka ndodhur me marrëveshjet e shmangies së tatimit të dy-

fishtë me vende të ndryshme. Ankesat dhe masat kundër evitimit cilësohen në një nivel të pranueshëm, por që ka vend për përmirësim. Vendet me situatën më pozitive janë Serbia dhe Maqedonia, të cilat kanë në total nga pesë tregues, katër prej tyre në nivelin më të mirë. Më keq parqitet pjesa e Bosnjë-Hercegovinës. Përtej problematikës, me mungesën e incentiveve në taksa, Shqipëria

do të vijojë të përfitojë nga marrëveshjet e të kaluarës, të lidhura me projekte madhore si TAP apo kaskada e Devollit. Deri në vitin 2016, investimet e huaja direkte rezultojnë me një vlerë 983 milionë euro, ndërsa objektivi është që ato të arrijnë 2.2 miliardë euro. Në rajon udhëheq Serbia, e cila në fund të vitit 2016 regjistroi një vlerë të IHD-ve prej 2.08 miliardë euro, ndërsa targeti i saj është për të paktën



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

2.5 miliardë euro deri në vitin 2020. Por, ndërsa objektivat i vendosin vetë vendet, tendencat që janë shfaqur në tregje për përthithjen e investimeve tregojnë se Shqipëria ka konkurrencë agresive për atë kohë sa in-

teresi ka qenë në industrinë automotivë, e cila nuk ka preferuar vendin tonë si dhe manufakturë. Në këtë kontekst sektorët mbi të cilët mund të bazohet lufta e Shqipërisë është turizëm, infrastruktura dhe energji.

Zyrtarizohen tarifat e reja për furnizimin me ujë në Tiranë dhe rrethe

# Tarifa e re për ujin, ja sa do paguajnë familjet dhe bizneset

Vendimi i ERRU, zbardhet tabela e re e çmimeve

Ornela Manjani

Tarifat do të jenë tarifa volumetrike për shërbimin, ku specifikohet se klientët familjarë do të paguajnë 65 lekë/m<sup>3</sup>, klientët publikë 140 lekë/m<sup>3</sup>, klientët privatë 155 lekë/m<sup>3</sup>, klientët e veçantë (prodhim pishesh alkoolike, pishesh freskuese, pishina) 170 lekë/m<sup>3</sup>, furrat e bukës 95 lekë/m<sup>3</sup>, për shitje uji me shumicë tarifa do të jetë 12 lekë/m<sup>3</sup> dhe për HEC-in e Lanabregasit 5 lekë/m<sup>3</sup>. Tabela me çmimet e reja është botuar në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar të vitit të ardhshëm.

### TARIFAT

Pas miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë nga Enti Rregullator i Ujit, tashmë vendimi i miratuar në fillim të nëntorit është zyrtarizuar edhe më tej me botimin e tij në "Fletoren Zyrtare", ku janë specifikuar edhe tarifat e reja për konsumatorin familjar dhe për bizneset në Tiranë. Sipas vendimit të fundit të Entit Rregullator të Ujit, tarifat do të jenë tarifa volumetrike për shërbimin, ku specifikohet se klientët familjarë do të paguajnë 65 lekë/m<sup>3</sup>. Në vendimin e botuar në Fletoren Zyrtare përcaktohet se klientët publikë do të paguajnë 140 lekë/m<sup>3</sup>, klientët privatë 155 lekë/m<sup>3</sup>, klientët e veçantë (prodhim pishesh alkoolike, pishesh freskuese, pishina) 170 lekë/m<sup>3</sup>, furrat e bukës 95 lekë/m<sup>3</sup>, për shitje uji me shumicë tarifa do të jetë 12 lekë/m<sup>3</sup> dhe për HEC-in e Lanabregasit 5 lekë/m<sup>3</sup>. Nga ana tjetër, konsumatorët mund të paguajnë tarifë fikse, ku për kategoritë e mësipërme pagesat do të jenë 200 lekë në muaj për klient. Në vendimin e Entit Rregullator të Ujit publikohen edhe

### TARIFAT

Konsumatorët mund të paguajnë tarifë fikse, ku për kategoritë e mësipërme pagesat do të jenë 200 lekë në muaj për klient. Në vendimin e Entit Rregullator të Ujit publikohen edhe tarifat që do të aplikohen për konsumatorët për largimin e ujërave të ndotura. Vendimi me tarifat e reja do të hyjë në fuqi më 1.1.2018. Shitje e ujit me shumicë për shoqërinë Ujësjellës Ura Vajgurore.

### TARIFAT E REJA TE UJIT PER FAMILJET DHE BIZNESET

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:		
Kategoria e Klientëve	Furnizim me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Klientë familjarë	65 lekë/m <sup>3</sup>	11 lekë/m <sup>3</sup>
Klientë publikë	140 lekë/m <sup>3</sup>	30 lekë/m <sup>3</sup>
Klientë private	155 lekë/m <sup>3</sup>	35 lekë/m <sup>3</sup>
Klientë të veçantë (Prodhim pishesh alkoolike, pishesh freskuese, pishina)	170 lekë/m <sup>3</sup>	40 lekë/m <sup>3</sup>
Furra buke	95 lekë/m <sup>3</sup>	13 lekë/m <sup>3</sup>
Shitje uji me shumicë	12 lekë/m <sup>3</sup>	-
HEC Lanabregas	5 lekë/m <sup>3</sup>	-

b) Tarifë fikse	
Klientë familjarë	200 lekë/muaj/klient
Klientë publikë	200 lekë/muaj/klient
Klientë private	200 lekë/muaj/klient
Klientë të veçantë (Prodhim pishesh alkoolike, pishesh freskuese, pishina)	200 lekë/muaj/klient
Furra buke	200 lekë/muaj/klient



### Tatimet sqarojnë profesionet e lira

## Procedura si do e paguajnë TVSH-në avokatët

Pasi Gjykata Administrative rrëzoi vendimin e qeverisë që parashikonte që avokatët do të paguanin TVSH nga zero, Tatimet kanë sqaruar mënyrën se si do të veprohet tani. Sipas Tatimeve, përfshihet në skemën e TVSH-së, vetëm pasi të plotësojë kriterin e qarkullimit të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Aktualisht ky kufi është 5 milionë lekë, ndërsa nga 1 prilli, kufiri do të ulet në 2 milionë lekë. Sipas njoftimit të Tatimeve: "Bazuar në vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, nr.00-2017-1809, datë 19.07.2017, i cili ka shfuqizuar pjesërisht aktin administrativ VKM nr.953, datë 29.12.2014 'Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014' 'Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë' në nenin 11, pika 2, për profesionin e avokatit, duke e trajtuar profesionin e avokatit si një veprimtari ekonomik që duhet të përfshihet në skemën e TVSH-së, vetëm pasi të plotësojë kriterin e qarkullimit të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe në referencë të ligjit 92/2014 'Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH', i ndryshuar, nenin 120 dhe 122. Të gjitha subjektet tatimpaguese që janë të regjistruar dhe ushtrjnë profesionin e avokatit, mund t'u drejtohen drejtorëve rajonale, ku ata janë të regjistruar për të deklaruar në mënyrë individuale zgjedhjen për të qenë pjesë ose jo e skemës së TVSH-së, në mënyrë që këta të fundit të ndryshojnë përgjegjësinë tatimore për subjektet tatimpaguese që ushtrjnë profesionin e avokatit. Ndërkohë, me parqitjen e tyre pranë shërbimit të tatimpaguesve në DRT përkatëse, do të orientohen për procedurat e mëtejshme që do të ndjekin", përfundon njoftimi.

### FURNIZIMI ME UJE DHE ARKETIMI I FATURAVE

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2018, 2019 dhe në fund të vitit të 5-të (2022) janë sipas planit të biznesit si më poshtë:

Treguesit e performancës	Viti 2018	Viti 2019	Prishmëria/viti 2022
Uji pa të ardhura (humbjet)	65%	60%	40%
Niveli i matjes	77%	78%	97%
Kohëzgjatja e furnizimit			24 orë/ditë
Eficientia e stafit			2.45 punonjës/000/lidhje
Mbulimi me ujë	90%	93.5%	95.3%
Mbulimi me kanalizime	78.7%	80.1%	83.5%
Norma e arkëtimit	90%	91%	92%
Cilësia e ujit (klor+kolorim)	Sipas standardeve	Sipas standardeve	Sipas standardeve

tarifat që do të aplikohen për konsumatorët për largimin e ujërave të ndotura. Vendimi me tarifat e reja do të hyjë në fuqi më 1.1.2018. Shitje e ujit me shumicë për sho-

qërinë Ujësjellës Ura Vajgurore. Po në Fletoren Zyrtare është botuar edhe vendimi për shitjen e ujit me shumicë për shoqërinë Ujësjellës Ura Vajgurore, ku

thuhet: "Miratohet tarifa e shitjes së ujit me shumicë për shoqërinë Ujësjellës Ura Vajgurore sh.a.: a) Tarifë shitjeje uji me shumicë do të jetë 29 lekë/m<sup>3</sup>".



**Çështja "Vollga", përballje mes biznesmenit, shoferit dhe noteres**

**Dëshmi kontradiktore për dosjen "Shullazi", Gjykata vendos për tri ballafaqime**

Gjykata vendosi të pranojë kërkesën e prokurorisë për të ballafaquar mes tyre biznesmenin Ylvi Bejja, shoferin e tij dhe noteren, në përpjekje për të nxjerrë të vërtetën e kërcënimit të Bejjas nga Emiliano Shullazi për dhurimin e hotel Vollgës. Trupa gjykuese vendosi që në seancën e radhës të realizohet përballja mes tyre, pasi më herët kanë dhënë dëshmi kontradiktore. Bëhet fjalë për momentin kur Emil-

**DËSHMITË**

Më herët Ylvi Bejja ka dëshmuar në gjykatë se e nënshkroi kontratën nën kërcënimin e Shullazit dhe të pandehurve të tjerë. Ndërkohë noterja Spahiu ka deklaruar se kontrata është firmosur para saj nga Emiliano Shullazi dhe Ylvi Bejja, me vullnetin e lirë të të dyve.

jano Shullazi dhe Bejja kanë nënshkruar në zyrën e noteres Spahiu, një kontratë dhurimi, sipas së cilës i pandehuri bëhej pronar në 30 për qind të ish-hotel Vollgës. Më herët Ylvi Bejja ka dëshmuar në gjykatë se e nënsh-

kroi kontratën nën kërcënimin e Shullazit dhe të pandehurve të tjerë. Madje në momentin kur hodhi firmën, thekson ai, grila e zyrës së noteres ishte e mbyllur. Ndërkohë noterja Spahiu ka dhënë një version tërësisht



Emiliano Shullazi

të ndryshëm. Para gjykatës, ajo ka deklaruar se kontrata është firmosur para saj nga Emiliano Shullazi dhe Ylvi Bejja, me vullnetin e lirë të të dyve. Për të njëjtin fakt, me noteren Spahiu do të përballlet dhe Besnik Musai, shoferi i Ylvi Bejjas, i cili më herët ka deklaruar se Shullazi e kërcënoi me armë biznesmenin dhe ai e pas skemën nga makina. Më pas

të dy hynë brenda në zyrën e noteres dhe pasi u mbyll dera, kontrata u nënshkrua. Ndërkohë gjatë seancës së djeshme, pati debate të forta, lidhur me leximin e deklarimeve të dhëna nga biznesmeni Jani Zaka, prona e të cilit sipas prokurorisë, është shkatërruar me eksploziv nga grupi kriminal i drejtuar nga Shullazi.



**Akuzohet për pastrim parash, pranga italianit në Tiranë**

**TIRANË** - Një shtetas italian i shpallur në kërkim ndërkombëtar është arrestuar dje në Tiranë. 50-vjeçari italian, banues në Tiranë do të ekstradohet në Itali, ku edhe është dënua nga gjykata e këtij vendi. Uniformat blu bëjnë me dije se ka rënë në pranga Ciro Dentice, 50 vjeç, banues në Tiranë. I shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi autoritetet gjyqësore në Trieste, Itali, me Vendim Nr. SIEP 154/2012, datë 17.05.2012, e kanë dënua me 5 vjet e 2 muaj burg, për veprën penale "Shkelja e ligjit mbi drogat, kokainë", "Pastrim parash", "Falsifikim", "Armëmbajtje pa leje", ku i kanë mbetur për të vuajtur 3 vjet, 3 muaj e 7 ditë burg. Materialet në ngarkim të tij i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprime të mëtejshme.

Nis hetimi pasuror për gjyqtarin e Apelit, në "sitë" llogaritë bankare dhe pronat e tij

**U kap me 340 mln lekë në shtëpi, Shkëlqim Miri apelon masën e sigurisë**

*Prokuroria: Kushëriri "sekser" refuzon të japë shpjegime*

Gjykatësi Shkëlqim Miri i arrestuar më 10 nëntor 2017 nën akuzën e korrupsionit, përmes avokatit të tij, Ardian Visha, ka kërkuar në Apelin e Krimeve të Rënda ndryshimin e masës së sigurisë nga "Arrest me burg" në një masë më të lehtë, që iu përshtatet kushteve të tij. Gjykatësi i Miri pretendon se vuan nga një sëmundje e rëndë dhe qëndrimi në burg ia përkeqëson shëndetin edhe më shumë. Më herët avokati i tij mbrojtës ka deklaruar se Shkëlqim Miri është diagnostikuar me tumor që prej muajit maj. Shumën e parave prej 340 milionë lekësh, që iu gjetën në shtëpi, sipas avokatit, ua kishte marrë borxh të afërmeve dhe do ta përdorte për t'u kuruar. Ndërkohë gjykatësi vijon të mohojë akuzat për përfshirjen në skemën korruptive për lirimin nga burgu të Gentian Dodës, të cilit iu ndryshua akuzat nga vrasje me paramendim, në plagosje të rëndë me pasojë vdekjen. Ndërkaq, kushëriri i tij, Kujtim Miri, i cili dyshohet se ka luajtur rolin e sekserit, ka refuzuar të japë shpjegime përpara prokurorëve. Ai u shoqërua nga qelia e paraburgimit në ambientet e organit të akuzës, por u largua prej andej, pa u rrefyer. "Jam në gjendje jo të mirë shëndetësore. Preferoj të jap shpjegime në një moment tjetër", - u ka thënë ai hetuesve.



Shkëlqim Miri

**KUJTIM MIRI**

Kujtim Miri, kushëriri i Shkëlqim Miri, i cili dyshohet se ka luajtur rolin e sekserit, ka refuzuar të japë shpjegime përpara prokurorëve. "Jam në gjendje jo të mirë shëndetësore. Preferoj të jap shpjegime në një moment tjetër", - u ka thënë ai hetuesve.

vitin 1997, nga vrasje, në plagosje e rëndë me dashje. Ky ndryshim mase bëri të mundur lirimin e Dodës nga burgu dy muaj më parë. Në kërkim është shpallur Alban Buci mik i afërt me Dodën, i cili sipas organit të akuzës është njeriu që ka dorëzuar paratë të Kujtim Miri. Ky i fundit, thuhet në

dosje e ka marrë zarfin në emër dhe për llogari të gjykatësit të karrierës. Shkëlqim Miri u pezullua nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjatë kontrollit në banesën e gjykatësit Shkëlqim Miri, me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, të kryer nga struk-

turat e Hetimit të Korrupsionit në Policinë e Shtetit, u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 174,810 euro; 10,149,000 lekë dhe 1,000 dollarë. **HETIMI PASUROR** Prokuroria e Krimeve të Rënda nis hetimin pasuror për gjyqtarin e arrestuar për korrupsion Shkëlqim Miri. Burime nga akuzat bënë me dije se është kërkuar zyrtarisht informacion nga të gjithë bankat e nivelit të dytë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, informacion në lidhje me llogaritë bankare dhe pronat që rezultojnë në emër të

gjyqtarit apo familjarëve të tij. Hetimet kanë nisur nga akuzat pas procedimit dhe arrestimit të gjyqtarit Shkëlqim Miri për veprën penale të korrupsionit dhe mitmarjes për një vendim gjyqësor. Rezultoni se Miri ka qenë pjesë e treshe gjykuese, e cila la në fuqi një vendim të gjykatës së Matit, e cila kishte ndryshuar akuzën për shtetasin Gentian Doda nga vrasje në plagosje me pasojë vdekjen. Për këtë procedim gjyqtari u prangos më datë 10 nëntor 2017 dhe për të Krimet e Rënda caktuan masën e sigurisë arrest me burg.



**Shiste ekstazi pranë shkollave të mesme, arrestohet 30-vjeçari**

**TIRANË** - Një 30-vjeçar, i identifikuar si Erind Krakulli, banues në Tiranë, është arrestuar ditën e djeshme në Tiranë, pasi dyshohet për shitje droge dhe armëmbajtje pa leje. Sipas policisë, Krakulli shiste lëndë psikotrope të llojeve të ndryshme, por kryesisht "Ekstazi, MDMA", pranë shkollave të mesme në Tiranë. Gjatë kontrollit fizik dhe në banesë iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale: 60 pilla të dyshuara si lëndë psikotrope (ekstazi); 1 kreherë pistoleta model 54; 4 fishekë luftarake model 54; 1 aparat celular i markës "Iphone 5". Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprat penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit".

**AKUZA**

Gjykatësi Shkëlqim Miri vijon të mohojë akuzat për përfshirjen në skemën korruptive për lirimin nga burgu të Gentian Dodës, të cilit iu ndryshua akuzat nga vrasje me paramendim, në plagosje të rëndë me pasojë vdekjen.

## DOKUMENTET E DIKTATURES NGJARJET

**EKSKLUZIVE /** Publikohet dokumenti i 21 nëntorit 1947, i Gjykatës Ushtarake të Elbasanit, me funksione në Peshkopi, mbi dënimin e të ashtuquajturit "Grupi i intelektualëve"

# Si i dënoi Myftar Grabocka me vdekje Edip Tërshanën, Jani Konomin dhe Hysni Alimerkon

*Vendimi: Të pandehurit, të lidhur prej kohe dhe anëtarë të organizatës terroriste të ashtuquajtur Parti Demokratike, Socialiste, Ball, Legalitet e të tjera*

Dashnor Kaloçi  
Spartak Topollaj

Ashtu siç theksuam edhe në një nga shkrimet e para pak ditëve, të botuara ekskluzivisht në faqet e "Gazeta Shqiptare", (referuar një dokumenti arkivor të vitit 1970-të), që me ardhjen e tij në pushtet në fundin e nëntorit të vitit 1944, e deri në fundin e 1990-ës, regjimi komunist i Tiranës filloi dhe vijoi në mënyrë lineare, goditjet me arrestime, burgime, ekzekutime dhe internime ndaj të ashtuquajturve grupe armiqësore, të cilat në pjesën më të madhe të tyre i inskenonte vetë me anë të Sigurimit të Shtetit. Një gjë e tillë rezultoi të ketë ndodhur edhe plot 50 vjet më parë, në 21 nëntorin e vitit 1947, kur Gjykata Ushtarake e Elbasanit që shtrinte funksionet e saj edhe në qytetin e Peshkopisë, gjykoi dhe dënoi një të ashtuquajtur grup armiqësor, të kryesuar prej: Edip Tërshanës, Jani Konomit dhe Hysni Alimerkos, të cilat të akuzuar si "koka e grupit" u dënuan me vdekje. Ndërsa pjesa tjetër e të pandehurve, morën dënime të ndryshme; nga burgime përjetë, deri 15 vjet heqje lirie. Ashtu siç bëhet e ditur edhe nga ky dokument arkivor, me vendimin e Gjykatës Ushtarake të Elbasanit të kryesuar prej Kapitenit të I-rë, Myftar Grabocka, që e publikojmë ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare", grupi në fjalë përbëhej prej pjesës më të madhe nga intelektualë me shkollë të larta (të diplomuar në universitetet e Europës), të cilët gjatë luftës ishin rreshtuar në anën e të ashtuquajturit Frontit Demokratik dhe deri në atë periudhë kohe që edhe u arrestuan, kishin shërbyer si nëpunës të Pushtetit Popullor. Arrestimi dhe dënimin e tyre vinte pas dënimin të ashtuquajturit "Grupi i deputetëve" në Tiranë dhe gjithnjë duke iu referuar dokumentit në fjalë, edhe "Grupi i Peshkopisë", kishte lidhje me atë grup që ishte dënuar në Tiranë. Përveç vendimit të dënimin të këtij grupi, në këtë shkrim po publikojmë edhe një letër promemorie që Edip Tërshana, i cili etiketohet si "koka e



Edip Tërshana

grupit" i ka dërguar Enver Hoxhës, pak para ekzekutimit. Promemoria në fjalë, të cilën Tërshana mundi ta nxirrte nga qelia të fshetur në rrobat e trupit që i merrte familja, duhet thënë se është mjaft e njohur, pasi është publikuar edhe herë të tjera, por ne po e risjellim në vëmendje të lexuesit, për të parë kthjelltësinë e mendimit, analizën e thellë dhe guximin e treguar prej tij, për t'ia thënë hapur Enver Hoxhës, mbi regjimin kriminal që ai dhe klika e tij po instalonin në Shqipëri. Si dhe për ta krahasuar atë promemorie me vendimin e Gjykatës Ushtarake, (anën propagandistike dhe politike të tij), ku duket qartë një hendek i madh...!

### VENDIMI I GJYKATËS USHTARAKE TË ELBASANIT

Akt-gjykimi Gjykatës Ushtarake të Elbasanit me funksione në Peshkopi, mbi dhënimin e dënimeve me vdekje të Edip Tërshanës, Jani Konomit, Hysni Alimerkos dhe të dënuarëve me privim lirie të akuzuarëve të tjerë të Grupit të Peshkopisë.

#### Peshkopi 21.11.1947 Nëmen të popullit

Gjykata Ushtarake Elbasan me funksione në Peshkopi, u formue prej:

Kapiteni i I-rë Myftar Grabocka

Kryetar  
Toger R.... H....  
Antar  
N/Toger Sh....  
I.... Antar  
L.... Toger Sh....  
Tue qenë gati dhe prokurori, Kapiteni i II-të, K..... M.... dhe me asistimin e Sekretarit kapterr, A.... H....

Sot me datë 21.11.1947 u mbëlth për të gjykuar të pandehurit; Edip Tërshana nga Dibra e Madhe dhe banues në Peshkopi, i rreshtuar më datë 17 maj 1947, 2) Jani Konomi nga katundi Nartë e Vlorës dhe banues në Vlorë, i rreshtuar më datë 25.8.1947, 3) Hysni Alimerko nga katundi Tragjas

i Vlorës dhe banues në Vlorë, 4) Rexhep Mborja nga Mborja e Korçës dhe banues në Korçë, 5) Alqi Nushi lindur dhe banues në Berat i rreshtuar më datë 3.11.1947, 7) Abaz Shehu lindur dhe banues në katundin Brezhdan të Peshkopisë, i rreshtuar më datë 23 qershor 1947, 8) Refat Dibra nga Shkodra dhe banues në Peshkopi provizorisht, i rreshtuar më datë 19 qershor 1947, 9) Medi Ndreu, lindur dhe banues në katundin Sllovë të Peshkopisë i rreshtuar më datë 17; 9.1947, 10) Adem Shehu lindur dhe

banues në katundin Brezhdan të Peshkopisë i rreshtuar më datë 17.9.1947, 11) M.... Sh.... (nuk lexohet emri), lindur në Tiranë dhe banues në Peshkopi i rreshtuar më datë 17 maj 1947 dhe 12) F... P... (nuk lexohet emri), lindur dhe banues në Zërqaq i rreshtuar më datë 17.9.1947, të akuzuar se:

Gjithë të pandehurit e sipërpërmëndur, dyke qenë të organizuar me njëri tjetrin në grupe të ndryshme terroriste, kanë kryer faje kundra popullit dhe Shtetit, duke patur si qëllim kryesor rrëzimin e Pushtetit Popullor me violencë.

#### Pasi bisedoj çështjen në fakt- Konstaton

Se të gjithë të pandehurit në bashkëpunim njëri me tjetrin dhe në mënyrë të organizuar kanë formuar grupe të ndryshme terroriste si në qytet (Peshkopi), ashtu dhe në rrethe, me në krye të pandehurit; Edip Tërshana, Jani Konomi, Hysni Alimerko, Rexhep Mborja, Alqi Nushi dhe në bashkëpunim edhe me të pandehurit, Selim Gramani, Adem Shehu e të tjerë si Refat Dibra (..... pesë personave nuk iu lexohet dot emri) ku një pjesë e të pandehurve duke qenë të lidhur prej kohe dhe anëtarë të organizatës terroriste të ashtuquajtura Parti Demokratike, Socialiste, Ball, Legalitet e të tjera, organizata këto terroriste që janë zbuluar me komitetet e tyre Qëndrorë në Tiranë duke patur në krye armiq të popullit dhe të shtetit si Gjergj Kokoshi, Suat Asllani, dhe më në fund



Gjyqi special, 1945

Grupin e Deputetëve tradhëtarë e të tjerë si këta, të cilët organizata, të pandehurit kanë pasë lidhje të ngushta duke qenë antarë të tyre dhe si të tillë kanë marrë angazhime për zgjerimin e këtyre organizatave duke punuar në këtë Qark dhe në rrethe të tjera.

Për të gjitha këto, gjykata bje bindje të plota se gjithë të pandehurit kanë qenë koshienta për veprimtarinë e kryer dhe armiq të betuar të Pushtetit Popullor, duke qenë konsekuent në këtë drejtim, pse kanë ditur mirë konsekuencat e veprimtarisë, mbasi të gjithë të pandehurit, me përjashtim të tre katër rasteve, janë elementa intelektualë me arsim të lartë dhe nëpunës të Pushtetit që kanë ditur të peshojnë çdo gjë, dhe si të tillë, janë përgjegjës si për sabotimin e punës në çdo sektor që u kishte besuar Pushteti, ashtu dhe për ekzistencën e të arratisurve kriminelë dhe armiq të popullit në këtë Qark.

Veprimtarija e të gjithë të pandehurve provohet me deponimet e tyre direkte dhe pjesërisht indirekte para gjyqit, ashtu dhe me process-verbalet e zhvilluara nga seksioni i Sigurimit të Shtetit, si dhe nga rreelacionet Shkoqitëse të Prokurorisë Publike të këtij Qyteti.

Fajësia e të gjithë të pandehurve parashiokohet prej Nenet 3 të numrave 1,3 e 8 të ligjeve Nr. 372 datë 12 Dhjetor 1946, mbi fajet penale kundra popullit dhe Shtetit, botue në Fletoren Zyrtare Nr.118 datë 28.12.1946 dhe i ndëshkuem prej nenit 4 paragrafi i I-rë po të ligjës së sipërme.

#### Prandaj

Trupi gjykoës bashkërisht dhe konform kërkimit të prokurorit

#### Vendosi

Dënimin e të pandehurve Edip Tërshana nga Dibra e Madhe, Jani Konomi nga Narta e Vlorës dhe Hysni Alimerko nga Tragjasi i Vlorës me VDEKJE, humbje e përherëshme e të drejtave Politike civile. Dënimin e të pandehurve; Rexhep Mborja dhe Alqi Nushi me privim lirie për jetë, me punë të →







← detyrueshme si dhe me humbje të së drejtave Politike dhe civile për aq kohë.

Dënimin e të pandehurve; Selim Gracani, Adem Shehu me nga 15 vjet privim lirie, punë të detyrueshme si dhe humbjen e të drejtave Politike dhe civile për 5 vjet kohë. Dënimin e të pandehurit Rifat Dibrës me 10 vjet privim lirie, punë të detyrueshme dhe humbjen e të drejtave Politike dhe civile për 5 vjet kohë. Dhe dënimin e të pandehurve: (pesë personave nuk u lexohen dot emrat), me nga 3 vjet privim lirie, punë të detyrueshme dhe humbje e të drejtave Politike dhe civile për 5 vjet kohë. Tue fillue denimi simbolik datës së rreshtimit të tyre.

Të gjithë të pandehunve u caktohet për me paguen dhe shpenzimet gjyqore lek 54 solidarisht.

Përsa i përket dënimeve me Vdekje, aktet i dërgohen Gjykatës Lartë Ushtarake për Shqyrtim dhe Aprovim. Për të gjithë të pandehurit e tjerë ky vendim mund të kundërshtohet m brenda 8 ditëve nga data e deklarimit.

Peshkopi, më 21.11.1947  
S e k r e t a r i Kryetar i gjykatës Ushtarake  
(Beluli Sulo) Kapiten I-rë, Myftar Grabocka

Letra promemorie e Edip Tërshanës për Enver Hoxhën në 21 nëntor 1947

Tërshana: Enver, këtë varr po ja bani atdheut edhe me politikën tuaj të jashtëme

Enver!  
Ideali Kombëtar më ka ba që jam kundra Lëvizjes Nacional Çlirimtare.

Unë isha në Dibër krijuesi i saj. Lëvizja Nacional Çlirimtare është në tradhti të Atdheut, se jo vetëm hoqi dorë nga Kosova e Dibra, por sot me Pushtetin Popullor Shqipëria është në robëri të Beligradit politikisht dhe ekonomikisht.

Sot organizatorët Sllavë janë ata që drejtojnë punët shtetërore dhe para-shtetërore. Kjo është tradhti. Sot politika e jashtme e juaj sllave ka shkaktuar që UNÇ të jetë kundër nesh humbin shumë miq; kjo është Tradhëti.

Jam kundra për vrasjet me gjyq dhe pa gjyq, që i bëhen këtij populli, pse kështu don sllavi.

Për 20.000-30.000 që dergjen në burg se s'janë "Komunist" sllavë. Kjo është tradhti. Jam kundra se e plaçkiti.

Ky është pushteti që varfëroi tre-gun shqiptar për të vesh klyshët e Rusisë dhe e la popullin bythlakuriq, ndërkohë që ne kishim për 20 vjet vesh-mbathje; kjo është pra tradhëti.

Jam kundra këtij Pushteti, se është spekulator tue grabit popullin me Ligj dhe mallin e sekuestruar nga tregtarët po ja shet ma shtrenj se ç'e kishin ata, duke lanë në rrugë një numër familjesh të tregtarëve kinse janë spekulatorë. Kurse Pushteti është në spekulator, se ja mori misrin 10 lekë e ja shiti 11.50; ja mori grunin 10 lekë ja shiti 15 mori duhanin 15-20 fr dhe ja shiti 100-120 fr. Mallin e U.N.R.A.S nuk e pa populli, se një pjesë e madhe e tij, shkoi në Rusi e të Titua. Kjo është tradhti.

Jam kundra se për dy vjet kemi shpenzuar dy miliard e disa milion fr. shqiptar për të ushqyer Pecot e mashorët e Frontit. Sot thuhet gjithçka për pushtetin, ndërsa dje Nationalistat thonin gjithçka për Atdheun. A nuk janë tradhti këto?

Jam kundra thirrjeve "Jemi bijtë e Stalinit", sepse ulin shumë poshtë rininë, aq poshtë sa kur përmend Stalinin, të gjithë ngrihen në këmbë. Jam kundra se injoranca s'don kulturën; kështu duan sllavët. Kjo besoj është tradhti.

Jam kundra sepse s'ka liri fjale e shtyp të lirë. Ka vetëm terror. Kjo është shqiptarizëm: të rroj në Frontit, të tjerët të vdesin? Jam kundra se në Historinë për Shkollat Unike thuhet: Balkani në kohët e lashta banohej prej grekëve e maqedonasve e se ilirët e lavdishëm u zhdukën. Kështu i shërbëjmë imperializmit sllav. Pjetri tha: Rusia duhet të ketë tre sy: Viladivostok, Petrograd e Durrës dhe dishepulli i tij Stalinin me pushtetin tradhtar të sotëm në Shqipëri, ja mbritti dhe kësaj ëndre.

Jam kundra, se grabitni teshat e "reaksonarëve", si i quan ju pra grabit dhe ha. Kësaj i thonë me vjedhë lirisht.

Jam kundra, se oficerë të Mbrojtjes këtu në Dibër, arrijnë me grabitë gratë e botës, me grabitë karrionlat e teshat shtëpiake e askush nuk tha ndal. Kjo është poshtërsi.

Jam kundra, se tregtia, toka dhe nëntoka, Ekonomia Kombëtare janë në dorë të sllavëve. Njëzet shoqni jugosllave në ekonominë shqiptare, a s'është kjo tradhti e naltë?

Enver!  
Tue çfaq këto, tue qenë i

A collection of handwritten documents and notes in Albanian. The top document is a letter from Edip Tërshana to Enver Hoxha, dated 21.11.1947, discussing national liberation and political issues. Below it are several pages of notes and a list of names, including 'Kapiten I-rë' and 'Kryetar i gjykatës Ushtarake'. The bottom part of the page shows a large crowd of people, likely at a public gathering or trial.



Publiku gjatë gjyqit special, 1945

vendosur me Idealin Kombëtar, unë kam qenë, jam kundra Pushtetit e këtë ja kam vu në dritë popullit, i cili e ka pa dhe pranë se 95% është kundra Pushtetit. Revoltën veç terrori i madh e mban. Pret nënë e mjerë, pasi i jati të vrasë të birin e bijtë e vet. Edhe kjo është tradhti e pushtetit popullor. Ky pushtet futi përçarjen tokse e gegë, katolikë e ortodoksë, myslimanë e ortodoksë, pra tradhti e naltë.

More të mjerë, ju ka verbu fanatizma e ideologjisë dhe nuk shifni faktin që po i bëni popullit varrin.

Këtë varr, jeni tue ja ba Atdheut edhe me politikën tuaj të jashtme. A s'është tradhti? Rroftë Ideali Kombëtar, Rroftë Shqipëria me Kosovën, që ju ja falët Jugosllavisë! Rroftë Populli shqiptar!

Rroftë flamuri kombëtar i panjollsur!  
Edip Tërshana



**SHKURT**

**Sherr mes dy personave në Laç, qëllohet me armë zjarri**

**KURBIN** - Të shtënat me armë zjarri kanë tronditur mbrëmë qytetin e Laçit. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se shtetasi P. K. 39 vjeç ka bërë kallëzim në komisariatin e Kurbinit se ka pasur një konflikt me ka pasur një konflikt me shtetasin Z.Ll. 33 vjeç, para makinave të tyre në këtë qytet. Më pas P.K. është larguar për në shtëpi dhe tek hyrja e pallatit ka dëgjuar të shtëna me armë zjarri, ku pretendon dhe dyshohet se shtetasi Z. Ll. ka gjuajtur në ajër. Në vendngjarje është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një gëzhojë. Menjëherë grupi hetimor ka shkuar në vendngjarje dhe po heton për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje. Ndërkaq, blutë po vijojnë punën për kapjen e shtetasit Z.Ll. për hetime të mëtejshme.

**Tenton të vjedhë banesën, mbahet 5 orë peng nga i zoti**

**LUSHNJË** - Policia e Lushnjës ka arrestuar vëllezërit Shkëlqim Çollaku, 41 vjeç, banues në fshatin Çermë, Divjakë e Lulëzim Çollakun, 45 vjeç, banues në fshatin Shegas si dhe 31-vjeçarit Nertil Hajdarin, banues në fshatin Konjat, Lushnjë. Mësohet se mbrëmjen e 19 nëntorit, Shkëlqim Çollaku ka vjedhur në fshatin Konjat një motoçikletë të markës "Piaggio", pa targa, në pronësi të Nertil Hajdarit dhe e ka qarur për ta fshehur në banesën e vëllait të tij, Lulëzim Çollakut, të cilin e ka vënë në dëgjim për faktin se motorin e kishte vjedhur. Më pas, Shkëlqim Çollaku është kthyer në banesën e Hajdarit për të vjedhur sende të tjera, por është kapur nga ky i fundit, i cili e ka mbajtur dhe dhunuar fizikisht në banesën e tij për rreth 5 orë dhe më pas e ka lënë të lirë. Mësohet se Nertil Hajdari nuk ka njoftuar policinë për ngjarjen, por pasi e ka lënë të lirë 41-vjeçarin Çollaku, ka mbajtur motoçikletën e markës "ICO", me targa AP072 në pronësi të vëllait të tij, Lulëzim Çollaku, duke kryer vetëgjyqësi. Materiali e kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për veprën penale: "Vjedhje", në ngarkim të Shkëlqim Çollakut; "Përvetësimi i sendeve të vjedhura" në ngarkim të Lulëzim Çollakut, "Vetëgjyqësia" dhe "Heqja e paligjshme e lirisë" në ngarkim të Nertil Hajdarit.

**Operacioni "Forca e ligjit" në Fier, gjykata liron njërin nga 3 të arrestuarit: Është invalid**



Operacioni "Forca e ligjit"

nuk ka asnjë referim në Prokurorinë e Fierit për grup kriminal, apo për vrasje e rrëmbime, ashtu sikurse nuk ka asnjë referim për akuzat e trafikut të lëndëve të forta narkotike, si heroinë dhe kokainë. Gjithashtu, asnjë referim edhe për hetimin pasuror ndaj tyre, që policia deklaroi se kishte identifikuar

prona, që dyshoheshin si produkte të pastrimit të të ardhurave nga aktiviteti kriminal. Pas operacionit, blutë deklaruan në një njoftim për shtyp se tre personat e prangosur si anëtarë të grupit të strukturuar kriminal dyshohet se ndër vite në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë trafikuar

lëndë narkotike të llojit kokainë, heroinë dhe kanabis sativa brenda dhe jashtë Shqipërisë. Por pak ditë pas operacionit "Forca e ligjit", ka rezultuar se ai ishte një operacion i rëndomtë me tre të arrestuar, nga të cilët njëri paraplegjik, që lëviz me karrrocë dhe dy të tjerë që u kapën me 133 gr hashash.

dy të tjerët, Dritan Tusha dhe Bashkim Ahmeto akuzohen për prodhim dhe mbajtje të lëndëve narkotike dhe janë lënë në burg nga gjykata deri në përfundim të hetimeve. Ndryshe nga sa u deklaruar nga policia, ndaj tyre

Policia: Dy të moshuarit në Shkallnur u dhunuan nga një grup kriminal

**Shahe Elezi: Si na torturuan për 2 orë banditët e armatosur dhe me maska**

*"Bashkëshortin e lidhën me skoç dhe e lanë në gjak"*

Klodiana Haxhija

**DURRËS**

Ishite ora 12-12:30 e natës kur dëgjuam zhurmë. Dola bashkë me bashkëshortin të shikonim se çfarë po ndodhte, kur pamë tre grabitësit e maskuar. Njëri ishte jashtë, ndërsa dy të tjerët ishin futur brenda në shtëpi. Na kapën për fyti mua dhe burrin. Tim shoqë shtyrin për tokë. Ata qëlluan bashkëshortin, ndërsa mua më thanë t'u tregoj se ku i kishim paratë. Ua tregova vendin ku ndodheshin lekët (1 milion lekë të vjetra), por ata donin më shumë. Ne më shumë nuk kishim. Na bënë copash". Kështu ka deklaruar dje për "Gazeta Shqiptare" 69-vjeçarja Shahe Elezi nga fshati Shkallnur i Durrësit. E moshuara tha se kanë përjetuar ferrin gjatë përballjes me tre agresorët e armatosur, të cilët i dhunuan barbarisht dhe i bënë për spital. Një ditë pas ngjarjes që shokoi familjarët dhe banorët e zonës, 77-vjeçari Maliq Elezi ndodhet në Spitalin e Tramës në Tiranë, në gjendje kritike për jetën. Ndërkaq, policia e Durrësit është duke hetuar intensivisht për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes si dhe identifikimin e vënien në pranga të autorëve të krimit.

**DËSHMIA E TË MOSHUARËS**

Shahe Elezi dje ka treguar me detaje se si i masakruan maskat. "Ata na lidhën me skoç dhe plastmasë, ndërsa e goditën burrin me grushte, leva hekurit dhe mjete të forta, ndërsa i thoshin nxirr paratë. Unë u tmerrrova, ndaj iu përgjyera që ta linin të qetë burrin. Por, grabitësit vazhdonin ta godisnin tim shoq, ndaj unë u detyrova t'u tregoj vendin ku ishin paratë. U jam lutur duke u thënë: 'Mos e qëlloni bashkëshortin se është plak dhe do iu ngelën ndër duar', por nuk më dëgjoni. Më kanë goditur edhe mua. Shtëpinë e kthyen përmbys. Njëri më kërcënohte mua, tjetri godiste bashkëshortin, ndërsa i treti e ktheu shtëpinë përmbys për paratë. Na

**GRUPI KRIMINAL**

Burime nga policia e Durrësit bënë me dije se një bandë e rrezikshme dhe e armatosur ka vënë në shënjestër të moshuarit e vetmuar që kanë fëmijët jashtë shtetit. Sipas bluve, ende nuk është bërë i mundur identifikimi i pjesëtarëve të kësaj bande të rrezikshme. Po të njëjtat burime pohuan se nuk dihet nëse pjesëtarët e kësaj bande grabitësisht janë vendës apo nga rrethet e tjera të vendit.



Foto ilustruese

thoshin: 'I keni fëmijët në Greqi e në Itali, tregoni ku i keni paratë. Na i jepmi me të mirë se në të kundërt do t'ju

vrasim të dyve'. Grabitësit e lanë burrin tim në gjak. E godisnin nga koka dhe e ai i shkreti humbi ndjenjat", tha 69-vjeçarja. Ajo pohoi se janë torturuar për afro dy orë dhe në orën 5 të mëngjesit shkoi policia në shtëpi dhe i dërgoi në urgjencën e spitalit të Durrësit. E moshua-

ra nuk iu nda për asnjë moment bashkëshortit, i cili qëndroi deri në orën 19:00 të mbrëmjes së të hënës në repartin e kirurgjisë. Nga skaneri rezultoi se 77-vjeçari Maliq Elezi kishte hemorragji në tru, ndaj dhe u dërgua për mjekim më të specializuar në Tiranë.

**HETIMET**

Pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në fshatin Shkallnur, burime nga policia e Durrësit bënë me dije se një bandë e rrezikshme dhe e armatosur ka vënë në shënjestër të moshuarit e vetmuar që kanë fëmijët jashtë shtetit. Sipas bluve, ende nuk është bërë i mundur identifikimi i pjesëtarëve të kësaj bande të rrezikshme. Po të njëjtat burime pohuan se nuk dihet nëse pjesëtarët e kësaj bande grabitësisht janë vendës apo nga rrethet e tjera të vendit. Sipas hetuesve të çështjes, kjo bandë mbikëqyr të moshuarit, të cilët jetojnë të vetmuar dhe që mund të kenë të ardhura nga fëmijët emigrantë. Pasi i mbajnë nën mbikëqyrje, ata i sulmojnë gjatë orëve të para të mëngjesit kur "viktimat" e tyre janë në gjumë.

**Në 2016, fqinji e akuzoi të riun se i ngacmoi gruan**

**U dënua me 6.8 vite burg, vetëvaret në Burgun e Shënkollit 20-vjeçari nga Shkodra**



zënë pritë nga i riu, pas një debati që kishin pasur për shkaqe xhelozie. Në atë kohë, burime nga policia e Shkodrës deklaruan se Florian Kodra kishte shkuar në shtëpinë e të Topuzit për të mjekuar kërthizën nga vje-

hrra e tij (mjekim popullor). Ndërkaq, ky i fundit, pasi kishte mbaruar punën në biznesin familjar që menaxhonte në Theth, ishte kthyer në shtëpi ku dhe ka gjetur Florian Kodrën. 19-vjeçari është munduar që t'i shpjegojë arsytet se përse kishte shkuar në shtëpinë e tij, por aty ka nisur debati, pasi Nazmi Topuzi është bërë xheloz për gruan e tij, shtetasen D.D. 48 vjeçe, me të cilën, sipas policisë, jetonte prej 2-3 vitesh. I riu i ka mohuar akuzat që i ka bërë Nazmi Topuzi për të shoqen, por ai nuk është bin-

dur dhe i irrituar ka debatuar duke shkuar deri në përlëshje mes tyre. Pak ditë pas këtij debati të pasqaruar mes tyre, 19-vjeçari e ka ruajtur 49-vjeçarin dhe sapo ka dalë në oborrin e shtëpisë së vjehrrit të tij, shtetasit Gjovalin Djerri, e ka qëlluar atë me katër plumba me automatik. Për pasojë, Topuzi ka marrë dy plumba, duke u plagosur rëndë. Ajo që ka dëshmuar për debatin ka qenë gruaja e të plagosurit. 19-vjeçari e ka pranuar krimin që ka bërë, por nuk ka dhënë arsytet për ngjarjen e ndodhur.

**LEZHË** - Një 20-vjeçar nga Thethi është gjetur mëngjesin e djeshëm i vdekur në dushet e burgut të Shënkollit në Lezhë. Dys-

hohet se Florian Kodra (i dënua me 6.8 vjet burg) është vetëvarur me çarçaf. Ndërkohë, mbeten ende të paqarta arsyet që e shtynë të riun drejt këtij akti të rëndë. Mësohet se Kodra ishte burgosur për shkak të një vrasjeje të mbetur në tentativa në vitin 2016. Ai ka qëlluar me dy plumba një vit më parë shtetasin Nazmi Topuzi, i cili dyshonte se i riu i ngacmonte bashkëshorten. Fillimisht janë përfshur e më pas, Kodra e ka qëlluar me armë.

**KONFLIKTI ME FQINJIN**

Nazmi Topuzi i është



# VIP

Suplement  
*Pages*

E mërkurë 22 Nëntor 2017 GAZETA SHQIPTARE

## "BULEVARDI POLITIK"

- Deputetët shqiptarë kapërcejnë ndasitë e politikës në Bruksel
- Vajza e ish-presidentit "kapet mat" duke u puthur me të dashurin
- Ironia e deputetit të PD, Boçi: Hyrje me "kulturë" në veting
- Hajdari publikon foton me zyrtarin e lartë amerikan: Frymëzuese

Adelina Tahiri, "kokë e këmbë" në dashuri. Ja si e surprizon i dashuri biznesmen



Big Mama ndahet nga i dashuri. Ja çfarë ndodhi



## Rudina Dembacaj:

Flet aktorja:  
Ç'do t'i thosha Jozefina Topallit po ta kisha përballë

**Bashkëshorti im ka një xhelozë shumë seksi, më pëlqen ta provokoj**

*"Ja si është marrëdhënia ime me Robert Alkajm"*



Intervista

Flet aktorja: Ç' do t'i thosha Jozefina Topallit po ta kisha përballë

Pamela Aliaj

A të e kemi parë shpesh të jetë pjesë e rroleve të ndryshme humoristike, në fillim në "Portokalli" e më pas në "Al Pazar", ku ka spikatur më tepër me rolin e ish-kryeparlamentares, Jozefina Topalli. Kësaj radhe ajo vjen ndryshe. Aktorja e njohur e humorit, Rudina Dembacaj është pjesë e show-t të mirënjohur televiziv "Dance with me". Në një intervistë ekskluzive për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", Rudina ka folur lidhur me këtë eksperiencë të re të saj, ku ka bërë batuta edhe lidhur me "xhelozinë" që ka bashkëshorti i saj për të. Aktorja ka folur edhe për marrëdhëniet që ka me konkurrentët, me jurinë e sidomos me Robert Aliajn, ku e kemi parë që "konfliktet" shpesh me ta. Gjithashtu, ajo ka zbuluar se së fundmi do të jetë sërish pjesë e ekranit me një projekt ku është shprehur se do të punojë me ajkën e Shqipërisë.

**Është hera e parë që merrni pjesë në një show të tillë. Si është të jesh pjesë e "Dance with me"?**

Për mua DWM është një argëtim i jashtëzakonshëm dhe gjëja më e bukur është që unë filloj ditën me kërcimin. Gjëja e parë që bëj, janë dy orë prova kërcimi dhe kjo më ka dhënë një energji të jashtëzakonshme për të gjithë angazhimet e tjera që kam. Në DWM kam njohur shumë njerëz të bukur dhe po kaloj ditë të mrekullueshme edhe pse është edhe e lodhshme.

**Keni pasur kontradiktat apo diskutime me Robert Aliajn? Si mendoni, pse pothuajse gjithë konkurrentet zihen me të?**

Nuk kam pasur kurrë kontradiktat me Robert Aliajn, as gjatë spektaklit. Unë e vlerësoj shumë si artist Robertin dhe më pëlqen mënyra e tij e të bërit televizion. Sepse atë qëndrim që mban ai nuk e bën dot çdo njeri, dhe atij i shkojnë shumë.

**Si do të reagonit ju në rastin e Fiori Dardhës me Robertin? Do largoheshit nga DWM?**

Nuk e di si do të reagoja në rastin e Fiorit. Çdo njeri ka marrëdhëniet e veta personale me këdo. Për sa i përket marrëdhënies me Robertin, kam një marrëdhënie të shkëlqyer.

**Ju kemi parë shumë sensual në kërcimet e "Dance with me". A është paksa xheloz bashkëshorti juaj?**

Ma kanë thënë edhe të tjerë që kam dalë sensuale, nuk ka qenë qëllimi im. Falënderoj Albi Nakon që ka nxjerrë një anë tjetër timen, megjithatë pika ime e fortë është humori. Nëse unë kam nxjerrë në pah sensualitetin tim, mendoj se kjo e plotëson figurën time. Bashkëshorti ka një xhelozë shumë seksi. Unë ingranohem që ta bëj atë sa më shpesh xheloz, sepse kur ai bëhet xheloz, më pëlqen shumë.

**Ju kanë propozuar ndonjë format tjetër ku mund t'ju shohim së shpejti?**

Më kanë propozuar një superformat dhe unë e kam nder të jem pjesë e një formati të tillë. Nëse realizohet, unë do të punoj me

# Rudina Dembacaj:

## Bashkëshorti im ka një xhelozë shumë seksi, më pëlqen ta provokoj

"Ja si është marrëdhënia ime me Robert Aliajn"



ajkën e Shqipërisë.

**Jeni një mami i një vogëlushjeje të bukur tashmë 10 muajsh. Si keni arritur të keni një trup kaq në formë?**

Trupi im nuk është akoma në formën e duhur, por këtë e kam arritur me vullnet. Kam dhënë prova që e kam gjithnjë nën kontroll peshën. Humb kile kur të dua dhe sa herë të dua. (qesh). Gjatë shtatzënisë mora më shumë kile seç duhet, por arrita t'i humba me vullnet. Nuk është një gjë e lehtë, por as e jashtëzakonshme.

**Jeni edhe një nënë e përkushtuar edhe një femër në karrierë. Si ia arrini që i bëni të dyja?**

Në përkushtimin tim, ndaj kam gjetur një harmoni, sepse kam një bashkëshort që më ndihmon jashtëzakonisht shumë, më jep kurajë më shtyn të pranoj projekte të ndryshme dhe më ndihmon dhe fizikisht me goçën. Është edhe nëna ime që

vjen nga Lezha për të më ndihmuar me goçën.

**Viktoria është një nga gëzimet më të mëdha të jetës tuaj. A keni menduar që të sillni edhe një tjetër gëzim në jetë së shpejti?**

Ajo është gëzimi më i madh i jetës sime. Çfarëdolloj gjëje të jem duke bërë dhe sado e stresuar të jem, nëse mendoj për Viktorian unë buzëqesh direkt. Në momentin që kam atë çdo gjë më zvogëlohet. Sigurisht që shpresoj që ajo të ketë shumë motra e vëllezër, por për momentin nuk e imagjinoj fare.

**A ju është ofruar ndonjë rol në teatër që e keni refuzuar?**

Është hera e parë për mua që luaj në teatër. Nesër do të jem 3 ditë me shfaqjen "Boing Boing", me regji të Kiço Londos. Unë vij nga show humoristik televiziv dhe jo

nga Akademia e Arteve, nuk kam pasur rast të luaj më parë teatër. Nuk do ta refuzoja kurrë një rol, edhe pse pagesat janë të vogla, por është një pasion që më lindi që në kontaktin e parë me të dhe shumë vështirë të refuzoja një rol në teatër.

**Cili është roli që do ta qaniti roli i jetës suaj?**

Nuk e di kush është roli i jetës sime. Unë do punoj pafund, do krijoj personazhe e do luaj për sa kohë të jem e kërkuar nga publiku. Duhet të jem e madhe në moshë që të kthej kokën pas e të them se kush ka qenë roli i jetës sime. Unë men-

nit?

Mendoj se është vetë format i emisionit, "taksia" të jep një lloj komoditeti ku nuk ka kamera me stativ, studio, nuk ka njerëz të tjerë. Në momentin që je vetëm, duket një intimitet dhe të gjithë rehatohen e flasin lirshëm. Nuk kam një të preferuar, jam kënaqur me të gjithë. Madje më është dhënë mundësia të njoh nga afër njerëz të cilët vërtet më kanë surprizuar dhe të ndihem mirë. Nga "taksia" kam krijuar miq të veçantë dhe të vërtetë.

**Në një nga intervistat tuaja të**



doj se akoma nuk e kam arritur kulmin e karrierës.

**Aspironi të jeni pjesë e botës së filmit? Ju është bërë ndonjë propozim?**

Këto ditë më është bërë një propozim për film, për herë të parë. Pres të më japin skenarin, shpresoj të më përshtatet dhe do ta pranoj me kënaqësi. Po nuk punova sot kur do të punoj?

**Në "taksinë" tuaj keni ftuar shumë personazhe. Cili është i preferuari juaj që do donit të ft-**


mëparshme keni thënë se personazhi juaj i preferuar është Jozefina Topalli. Nëse do ta ftonit në "Mos i fol shoferit", cila është pyetja më pikante që do t'i bënit?

Nëse do kisha znj. Topalli në "Taksinë time" nuk do ta pyesja fare për politikën apo karrierën e saj. Do të doja të flisja anën njerëzore, intelektuale, familjare, private të saj dhe jam shumë e bindur se ajo ka shumë për të thënë për këtë.





Vetëm para pak kohësh është zbuluar se statusi i saj nuk është më single. Bukuroshja Adelina Tahiri ka treguar se tani është shumë e dashuruar, por që nuk ka zbuluar se kush është personi që ia ka rrëmbyer zemrën, transmeton Gazeta Express. Biondja seksi ka vendosur që personin e zemrës mos ta zbulojë se kush është. Dihet vetëm që ai është një biznesmen. Kohët e fundit ajo ka publikuar në llogarinë e saj në "Instastory" një video ku shihet se ka marrë dhuratë nga i dashuri një buqetë me trëndafila të kuq. "Faleminderit dashuria ime, të dua",-kishte lënë mbishkrim ajo. Më pas ka publikuar edhe një tjetër video ku shihet duke darkuar me familjen e saj, e që sigurisht prezent ka qenë edhe i dashuri i saj.



**ADELINA TAHIRI, "kokë e këmbë" në dashuri. Ja si e surprizon i dashuri biznesmen**

**BEATRIX zbulon këmbët, por ERMAL MAMAQI " e injoron" me reagimin e tij duke i marrë vëmendjen**



Ajo është një nga këngëtaret me më shumë stil në të veshur, përpos zërit të saj brilant. Beatrix Ramosaj ka postuar një foto me një mikeshën e saj dhe në përshkrim ka shkruar: "You can't sit with us" (Nuk mund të ulesh me ne). Ndërsa nuk kishte se si të mungonte komenti i Ermal Mamaqit nën foto, i cili ka shkaktuar të qeshura te fansat e saj. Ai i ka komentuar: "Ok, po iki te një lokal tjetër."

**BIG MAMA ndahet nga i dashuri. Ja çfarë ndodhi**

Mesa duket dashuria e këngëtares së njohur nuk ka zgjatur për shumë kohë. Para pak kohësh ajo tha se nuk ishte lidhje e shëndoshë, lidhja që ajo kishte. Këngëtarja e njohur, Besjana Kasami, apo siç njihet me emrin artistik "Big Mama" kohëve të fundit ishte kryefjalë e mediave rozë për linjat e saj trupore, ndërkohë që tani është bërë temë për ndarjen nga i dashuri. Bigu në një intervistë të bërë së fundmi ka treguar arsyen e ndarjes. "Kam folur të Fatma, të Rudina po flas për herë të tretë dhe nuk do të flas më. Unë provova një lidhje, ishte një lidhje serioze... u ndava, nuk shkoj, gjithçka ishte në rregull por, kemi qenë dy persona të botëve të ndryshme. Nuk ishte lidhje e shëndoshë për ardhmërinë tonë për çka vendosëm që unë të vazhdoj rrugën time ai të veten",-tha ajo. Big Mama ishte edhe prezantuese e emisionit "Mama's trip", tani ajo është pjesë e spektaklit "Cest la vie" në Shqipëri. Ndërkohë që një lajm tjetër ka dhënë Big Mama në intervistë. Ajo tha se pas përfundimit të këtij spektakli, do të rikthehet në ekranin e TV21 me emision të ri.



# BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

## POLITIK



### Deputetët shqiptarë kapërcejnë ndasitë e politikës në Bruksel

Shpesh herë jemi mësuar që deputetët shqiptarë, kur kapërcejnë kufirin, kalojnë edhe ndasitë politike që i mbrojnë me forcë brenda vendit gjatë aktualitetit të përditshëm politik. Por këtë herë politikanët shqiptarë kanë shkuar më tej, ata janë bërë bashkë me kolegët e tyre nga Kosova dhe Maqedonia. Kanë qenë pikërisht Glauk Kujofcka deputet i Vetëvendosjes, Blerita Deliu deputete e PDK, Taulant Balla dhe Evis Kushi deputetë të PS, Edmond Spaho deputet i PD dhe Artan Grubi deputet i BDI në Maqedoni. Të pestë këta deputetë kanë përfaqësuar 3 vende të ndryshme, por për një moment të vetëm ata janë ndjerë vetëm shqiptarë të gjithë.



Shpesh herë jemi mësuar që deputetët shqiptarë, kur kapërcejnë kufirin, kalojnë edhe ndasitë politike që i mbrojnë me forcë brenda vendit gjatë aktualitetit të përditshëm politik. Por këtë herë politikanët shqiptarë kanë shkuar më tej, ata janë bërë bashkë me kolegët e tyre nga Kosova dhe Maqedonia. Kanë qenë pikërisht Glauk Kujofcka deputet i Vetëvendosjes, Blerita Deliu deputete e PDK, Taulant Balla dhe Evis Kushi deputetë të PS, Edmond Spaho deputet i PD dhe Artan Grubi deputet i BDI në Maqedoni. Të pestë këta deputetë kanë përfaqësuar 3 vende të ndryshme, por për një moment të vetëm ata janë ndjerë vetëm shqiptarë të gjithë.

### Ironia e deputetit të PD, Boçi: Hyrje me "kulturë" në veting

Deputeti i Partisë Demokratike, Luçiano Boçi ka treguar një fakt të çuditshëm lidhur me ndërtesën ku janë vendosur institucionet e vetingut. Ndërtesa në "Rrugën e Kavajës" që gjerësisht njihet si godina e "Lidhjes së Shkrimtarëve" që nga tetori është vënë në dispozicion të organeve të vetingut. Por deputeti i PD-së Boçi në një postim tregon se ajo është rikonstruktuar në vitin 2017-të me fondet e Ministrisë së Kulturës, çka për të është e çuditshme. Boçi ironizon me këtë fakt sipas tij, duke shkruar, "Kësaj i thonë hyrje "me kulturë" në veting".



# BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

## POLITIK

### Vajza e ish-presidentit "kapet mat" duke u puthur me të dashurin

Malia Obama, vajza e madhe e presidentit Obama është filmuar këtë të shtunë teksa puthet me të dashurin e saj gjatë zhvillimit të lojërave të përvitshme në Harvard-Yale. Këtë vit studentët e Harvardit kanë ngritur godinën e tyre pranë godinës së Universitetit të Yale. Ky ka qenë pikërisht vendi ku është kapur "mat" vajza e ish-Presidentit të SHBA-ve, teksa puthet me një djalosh bukurorsh videoja ka marrë mijëra shikime nga momenti i publikimit, gjithësi mbetet të shpresojmë që të mos e ketë parë ende Obama.

© TMZ/MEGA

### Hajdari publikon foton me zyrtarin e lartë amerikan: Frymëzuese

Deputetja e re e Partisë Demokratike, Rudina Hajdari ishte dje e pranishme në një drekë pune bashkë me kryeministrin kosovar Ramush Haradinaj dhe kongresmenin amerikan Eliot Engel. Hajdari e ka bërë publike këtë foto në rrjetet sociale. Ajo e cilëson këtë darkë si inspiruese dhe i është mirënjohëse për eksperiencën që ajo ka fituar gjatë këtij takimi. "Drekë produktive me këta njerëz frymëzues, faleminderit që më bëtë pjesë në këtë përvojë!", shkruan Hajdari.





Rektori Et'hem Ruka: Programet, simbol i bashkëpunimit mes institucionit dhe tregut

# Kolegji Universitar "Luarasi" çel dy mastera profesionale

## Risi në sistemin e lartë arsimor në vend

Kolegji Universitar "Luarasi" sjell një risi në sistemin arsimor në vend me çeljen e dy programeve në master profesional "Siguria dhe Rendi Publik" si dhe "Menaxhim Sigurimesh". Këto degë ofrohen ekskluzivisht vetëm nga "Luarasi" për të gjithë studentët që dëshirojnë të vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve në këto fusha. "Këto dy mastera janë shumë të rëndësishëm, janë simbol i bashkëpunimit të institucionit tonë me nevojat e ekonomisë së tregut. Unë besoj se në këto dy mastera do të merrni njohuri që do t'u shërbejnë në punët tuaja. Faleminderit që keni zgjedhur universitetin tonë", - tha rektori i "Luarasi", prof. Et'hem Ruka.

### PROGRAMI "MENAXHIM SIGURIMESH"

Vetë kompanitë e sigurimeve kanë shprehur interes, pasi në tregun e kësaj industrie, Shqipëria ka nevojë në strukturim dhe rritjen e cilësisë. "Për herë të parë në Shqipëri kemi një master profesional 1-vjeçar, që lidhet me menaxhimin e sigurimeve. Kompanitë e sigurimeve kanë qenë shumë të interesuara. Në kursin e parë të sapohapur të masterit, një pjesë e madhe e studentëve punojnë në tregun e sigurimeve dhe duan e rrisin aftësitë dhe kapacitetet e tyre, që në Shqipëri të përmirësohet tregu i sigurimeve si dhe gama e produkteve që duhen ofruar. Një nga objektivat e këtij masteri është të formojë sa më



Rektori i "Luarasi", prof. Et'hem Ruka

shumë profesionistë. Industria e sigurimeve është në zhvillim e sipër në vendin tonë. Kërkojmë që edhe këtu kjo industri të rritet duke e zhvilluar ekonomikisht vendin", - u shpreh Mateo Spaho, dekan i Fakultetit Ekonomik në Kolegjin Universitar "Luarasi". Ndërkaq, kryetari i

Bordit të Autoritetit të Mbrojtjes Financiare, Patjim Melani u bëri thirrje të gjitha kompanive të sigurimeve që të specializojnë punonjësit e tyre në këtë program studimi, duke shtuar se nga ky universitet dalin studentët më të mirë për të cilët tregu ka shumë nevojë.

### PROGRAMI "SIGURIA DHE RENDI PUBLIK"

Ndërkaq, Fakulteti i Drejtësisë tek "Luarasi" ofron master profesional shumë të kërkuar nga punonjësit e strukturave të sigurisë së rendit publik dhe privat. Programi më i ri ka për qëllim të nxjerrë ekspertë në çështje



Takimi mes krerëve dhe studentëve të Universitetit "Luarasi"

të studimeve strategjike dhe të sigurisë, ku target-grupi janë uniformat blu apo efektivet e forcave të armatosura shqiptare. "Dega e re e studimit master profesional 'Për Sigurinë dhe Rendin Publik' është një risi e ofruar vetëm nga Kolegji Universitar 'Luarasi', pas kërkesave të shumta të të interesuarve pas studimit të tregut. Ky master profesional erdhi si nevojë e domosdoshme e kërkesave të tregut dhe kërkesave që kishin studentët sivjet. Mund të them që masteri 'Për Sigurinë dhe Rendin Publik' ishte një nga masterat, të cilin ne pasi studiuam tregun, e pamë që asnjë fakultet tjetër, asnjë universitet apo kolegji universitar, privat apo publik nuk e

ofronte këtë program studimi. Target-grupi që ka shprehur më tepër interes për të ndjekur këtë master janë të gjithë punonjësit e policisë, ata që shërbejnë në forcat e armatosura", - tha në fjalën e saj prof.dr. Rezana Konomi, dekanë e Fakultetit të Drejtësisë në "Luarasi". Të dyja këto mastera të ofruara ekskluzivisht nga Kolegji Universitar "Luarasi" zgjasin vetëm një vit akademik. Krerët e këtij institucioni shprehën se me dhjetëra studentë që janë në punë po ndjekin këta mastera profesionalë, pasi përfitojnë nga kohëzgjatja e shkurtër dhe njëkohësisht fitojnë një specializim të caktuar që ua kërkon vendi i tyre i punës.

### Operacion mbi pastrimin në vend

## Rama: Një mijë leje mjedisore pa kriter

Në të gjithë vendin brenda 10 ditësh janë fotografuar 9001 vende ku hidhen mbeturina, por aksioni për pastrimin e Shqipërisë do të kthehet në një operacion afatgjatë. Kjo është ajo çka deklaroi kryeministri Edi Rama, i cili theksoi se nisat për mbrojtjen e mjedisit nuk janë zbatuar. "Sot kemi situatë dramatike në të gjithë territorin, në të gjitha aspektet e ndotjes që prek trupin e vendit dhe njeriut pa mëshirë, si rezultat i mosmarrjes së përgjegjshmërisë. Në shifrat zyrtare një individ gjeneron 400 kg mbetje në vit, vetëm 40 shkon për riciklim, pjesa tjetër nuk dihet ku shkon", - u shpreh Rama. Më tej, ai tha se brenda 6 muajsh kjo situatë do të ndryshojë falë aksionit që po shndërrohet në operacion, duke

### DEKLARATA

"Për të gjitha këto nisat ne duhet të ishim ndër vendet e para në Europë, por në realitet ne jemi në vendet e fundit në Europë sa i përket zbatimit të ligjit. 1 mijë leje mjedisore që janë lëshuar pa kriter e pa karar, duke mos u bërë asgjë për monitorimin e zbatimit të tyre", tha Rama.

përdorur të gjitha mjetet e rrugët e komunikimit në çdo nivel, në mënyrë që Shqipëria turistike e vitit të ardhshëm të jetë më e lehtësuar nga mbetjet. "Ka 7 strategji në këto vite për mjedisin, 23 ligje për



mbrojtjen e mjedisit. 20 rekomandime, rishikime kombëtare, ndërkombëtare. 100 vendime qeverie, 20 udhëzime, 5 rregullore. Për të gjitha këto nisat ne duhet të ishim ndër vendet e para në Europë, por në realitet ne jemi në vendet e fundit në Europë sa i përket zbatimit të ligjit. 1 mijë leje mjedisore që janë lëshuar pa kriter e pa karar, duke mos u bërë asgjë për monitorimin e zbatimit të tyre", - tha kryeministri i vendit. Gjithashtu, ai theksoi se ky aksion ka nevojë për bashkëpunëtorë, organizma dhe reforma rrënjësore.

### Deda: Aksion për ndalimin e përdorimit

## ISHP: 67% e të miturve kanë provuar alkool, 1 në 5 prej tyre është dehur

Rreth 67% e të miturve në vendin tonë kanë provuar alkool të paktën një herë, bazuar në studimin e kryer së fundmi nga Instituti i Shëndetit Publik. Edhe pse ligji në Shqipëri e ndalon përdorimin e alkoolit nga të miturit, ISHP ka verifikuar se një në pesë të mitur është dehur një herë në jetën e tij. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka firmosur një urdhrë për të bërë kontroll gjatë 24 orëve në të gjitha baret, restorantet dhe klubet e natës në lidhje me këtë çështje. Kreu i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Eltar Deda, u shpreh se subjektet duhet t'i kontrollojnë të rinjtë për ofrimin e pijeve alkoolike, duke i kërkuar kartën e identitetit. "Ky si



fenomen do të luftohet ditën dhe natën në të gjitha institucionet, lokale, në mënyrë të atillë për të larguar të rinjtë nga përdorimi i alkoolit. Logon do ta vendosim në të gjitha lokale dhe çdo subjekt tregtar është i detyruar ta ndjekë, duke kërkuar dhe kartën e identitetit për të gjithë klientët e tyre, të cilët ata dyshojnë se janë nën moshën 18-vjeçare", -

tha Deda. Ndërkohë, në vendet e Bashkimit Europian, para se një adoleshenti t'i shitet apo shërben pije alkoolike, i verifikohet mosha nëpërmjet kartës së identitetit. Por sipas studimit, në Shqipëri dy në tre nxënës të klasave të nënta dhe viteve të para në gimnaz pohojnë se kanë konsumuar pije alkoolike.

## Kriteret për studentët, si do të bëhet përzgjedhja

### Ambasada amerikane: Ja kur është afati i fundit i aplikimeve për studime në SHBA



Ambasada amerikane

Për të gjithë ata që dëshirojnë të studiojnë në SHBA, ambasada amerikane bën me dije se aplikimet mund të kryhen brenda datës 31 dhjetor të këtij viti. Studentët e interesuar në këtë mënyrë bëhen pjesëmarrës në programin Global UGRAD. "Mos e humbini mundësinë tuaj për të kaluar një semestër në një universitet në SHBA. Ne pranojmë aplikime deri në datën 31 dhjetor! Edhe studentët e vitit të parë kualifikohen për këtë program, thjesht dërgoni dëftesën e shkollës së mesme dhe konfirmimin e regjistrimit në universitet bashkë me aplikimin tuaj." -thuhet në njoftimin e ambasadës. Ky program është i financuar nga Departamenti i Shtetit, i cili jep bursa për studentë të nivelit universitar në 55 vende të botës. Studentët caktohen në kolegje dhe universitete në të gjithë Amerikën, ku marrin pjesë në një semestër të nivelit parauniversitar pa diplomë.

Bursa mbulon udhëtimin, shkollimin, dhomën, sigurancionin për aksidente apo sëmundje, një pagesë të vogël mujore, dhe shpenzime për libra. Pjesëmarrësit jetojnë në konvikte me bashkëmohatarët e tyre amerikanë ose në banesa me familje amerikane. Gjithashtu, të përzgjedhurit, marrin pjesë edhe në shërbime komunitare si dhe të marrin pjesë në aktivitete të zhvillimit profesional. Finalistët do të përzgjidhen në bazë të rezultateve akademike, aftësive

drejtuese, dhe përgatitjes së tyre për të studiuar në Shtetet e Bashkuara. Global UGRAD është i hapur për të gjitha fushat e studimit dhe nuk është diskriminues ndaj racës, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, fesë, etnisë, ose paafetësisë fizike. Në këtë program mund të aplikojë çdo student shqiptar mbi 18 vjeç, i cili ka mbaruar vitin e parë të universitetit dhe është i regjistruar në çdo universitet të akredituar, publik ose privat, dhe ka të paktën një semestër për të

kryer në vendin e tij në përfundim të programit Global UGRAD. Fituesit duhet të jenë të gatshëm të fillojnë studimet në SHBA në gusht 2018 ose janar 2019.

kryer në vendin e tij në përfundim të programit Global UGRAD. Fituesit duhet të

jenë të gatshëm të fillojnë studimet në SHBA në gusht 2018 ose janar 2019.

Ja sa janë tarifat, si veprohet në rastet e refuzimit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore

Voltiza Duro

# Udhëzimi: Do të regjistrohen të gjitha diplomatat e certifikatat e arsimit të lartë

## Procedura që ndiqet për aplikim

Tashmë të gjitha diplomatat e certifikatat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, do të regjistrohen në formë të shkruar apo elektronike në regjistrin shtetëror. Ky vendim është publikuar dje në Fletoren Zyrtare ku është firmosur nga ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla dhe ka hyrë në fuqi menjëherë pas botimit. Ky regjistr shtetëror është një bazë unike të dhënash e të gjitha formave të diplomave dhe certifikatave të lëshuara në përputhje me legjislacionin, ndërkohë Qendra e Shërbimeve Arsimore arkivon dokumentet shoqëruese të paraqitura nga IAL përkatëse. "Institucionet e Arsimit të Lartë (në vijim IAL) kanë detyrimin ligjor të regjistrojnë të gjitha format e diplomave dhe certifikatave në Regjistrin shtetëror përpara datës së lëshimit të tyre, në kundërt ato nuk marrin vlerë ligjore."-thuhet në udhëzim. Në këtë të fundit paraqitet edhe mënyra e aplikimit pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe theksohet se dokumentet e dorëzuara duhet të jenë të sakta e të plota, në të kundërt nuk pranohen. Regjistrimi fillestar, si dhe regjistrimi i mëvonshëm i nënshtrimit, e cila do të jetë 3 mijë lekë për çdo formë diplome dhe certifikate të regjistruar. Dokumentet e dorëzuara duhet të jenë të sakta e të plota, në të kundërt nuk pranohen.



Foto ilustruese

### TARIFAT

Regjistrimi fillestar, si dhe regjistrimi i mëvonshëm i nënshtrimit, e cila do të jetë 3 mijë lekë për çdo formë diplome dhe certifikate të regjistruar. Dokumentet e dorëzuara duhet të jenë të sakta e të plota, në të kundërt nuk pranohen.

të përbajnë korrigeime apo fshirje e duhet të jenë në gjuhën shqipe apo të përkthyer dhe të vërtetuara në gjuhën shqipe dhe të legalizuara sipas legjislacionit në fuqi. Me tej, brenda një afati 30 ditor nga aplikimi, Qendra e Shërbimeve Arsimore do të kryejë shqyrtimin dhe veri-

fikimin e dokumenteve të paraqitura në dosjen e aplikimit. Në rastet kur aplikimi është i plotë bazuar në kërkesat e kërkuara, atëherë QSHA miraton formën e diplomës apo certifikatës dhe kryhet regjistrimi i tyre në regjistrin shtetëror. Pas kësaj, brenda 2 muajsh nga

data e paraqitjes së aplikimit, jepet vërtetimi i regjistrimit. Por në rastet që QSHA, pas verifikimeve konstaton se nuk janë përmbytur kërkesat e paracaktuara, atëherë ka të drejtë të bëjë pezullimin e aplikimit deri në plotësimin ose ndrejten e elementeve që pengojnë regjistrimin e formës së diplomës apo certifikatës. Ndërsa kur aplikimi nuk është në përputhje me legjislacionin dhe dokumentet paraqiten ndryshe nga të dhënat që kërkohen, Qendra e Shërbimeve Arsimore refuzon regjistrimin

dhe njofton Institucionin e Arsimit të Lartë përkatës mbi shkakun e këtij refuzimi. Ndërkaq çdo IAL e interesuar, së cilës i është refuzuar regjistrimi i formës së diplomës apo certifikatës, ka të drejtë të bëjë një ankimim brenda 30 ditësh në MASR. Në udhëzim bëhet me dije, gjithashtu, se çdo formë diplome apo certifikate, e regjistruar në regjistrin shtetëror, pajiset me një numër unik identifikimi, të cilin IAL-të janë të detyruara ta shënojnë në diplomatat apo certifikatat e lëshuara.



## Aksioni i AKU, kontrolle në vende ilegale apo të fshehta

Pas mbylljes së 94 thertoreve, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ka filluar aksionin për parandalimin e therjes së kafshëve në vende ilegale apo të fshehta. Gjatë inspektimeve të ditëve të fundit janë verifikuar e penalizuar disa subjekte, që në mënyrë të fshehtë therrnin kafshë dhe i tregtonin në dyqanet e tyre. Raste të tilla janë evidentuar në Domje të Tiranës, Gjirokastër, Lushnje, në Polican të Skraparit dhe Milot. Subjektet ku janë konstatuar këto shkelje janë gjobitur në vlerat 100-400 mijë lekë të reja si dhe është bërë sekuestrimi i sasive të konsiderueshme të mishit. Përkatësisht në Domje janë bllokuar plot 206 kilogramë mish i tregtuar jashtë kushteve higjieno-sanitare dhe është bërë gjobitja e subjektit me 250 mijë lekë të reja. Ndërsa në Polican, subjekti u gjobit në masën e 400 mijë lekëve të reja. AKU bën me dije se, ky aksion që do të përfundojë, por do të vazhdojë e do të jetë konstant, deri në rritjen e standardeve të sigurisë ushqimore.



PËRKUJTIMI

Të gjitha dëshmitë e të pandehurve, të marra në kushte presioni dhe torturash përshkruajnë se sabotimi i tharjes së Kënetës ishte kryer me qëllim shkaktimin e dëmeve të mëdha ekonomike vendit...

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Institutin e Historisë dhe Qendrën e Studimeve Albanologjike organizoi dhe takimin "E vërteta e inxhinierëve të kënetës së Maliqit". Mes të tjerash, Autoriteti ka zbardhur edhe disa të dhëna mbi dosjet e të dënuarve.

Në nëntorin e 1946, lajmi më i madh në Tiranë ishte gjyqi ndaj atij që u quajt me bujë "grupi i sabotatorëve të kënetës së Maliqit". Procesi, që transmetohej me altoparlant publikisht, u zhvillua në kinema "Nacional", në atë që më pas do të merrte emrin "17 Nëntori".


Qëllimi i këtij gjyqi ishte, në radhë të parë vijimi i politikës së asgjësimit të intelektualëve të edukuar në shkolla perëndimore, për shkak të kundërshtive që kishin këta të fundit ndaj regjimit të asaj kohe. Qeveria e Tiranës, donte t'i shkëputte e t'i prishte përfundimisht marrëdhëniet me SHBA-të dhe Britaninë e Madhe, për t'u kycur përfundimisht në perandorinë e kuqe komuniste, si një vend satelit i BS dhe si një shtojcë e Jugosllavisë. Për të justifikuar mostharrjen e kënetës në afatin e caktuar (1 Tetor 1946), realizuar me punën e të burgosurve politikë, si edhe me mjete primitive të punës dhe për të ushtruar e përhapur terror e frikë në popull, në mënyrë të veçantë të klasat e përmbytura borgjeze e demokrate.

GRUPI E KËNETËS SË MALIQIT

Përbëhej nga disa emra. Abdyl Sharra, ishte një 35-vjeçar nga Vlora, që kishte kryer shkollën teknike të "Robert Kolegjit" në Stamboll dhe Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Romë. U emërua kryeinxhinier në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit dhe pas tre muajsh arrestohet si "armik i popullit, si iniciatori kryesor i sabotimeve në stil të gjerë për ndërmarrjet e mëdha që bënte pushteti popullor".

Kujtim Beqiri, 30 vjeç nga Velça e Vlorës, bir i një familjeje patriotike (i ati pjesëmarrës aktiv në ngritjen e flamurit më 1912 dhe në luftën e Vlorës më 1920). Në vitin 1932 kryen Shkollën Teknike (dega elektrike). Në vitin 1940 përfundon me

KËNETA E MALIQIT
Dëshmitë e firmosura nën torturë:
Vepruam me urdhër të Harry Fultz-it



1946/ "Në këmbim të kryerjes së sabotimit, këta të dërguar kanë ofruar shpërblime në sterlina dhe monedha floriri"

medalje të artë inxhinierinë civile, rruga-ura në Universitetin e Vjenës. Në korrik 1946 dërgohet si drejtor në punimet e Maliqit. Vasil Mano, inxhinier në Kënetë, u akuzua bashkë me të shoqen Zyrakën (me kombësi jugosllave) për lidhje dhe kontakte të herë pas herëshme me agjentët e UNRRA-s. Zyraka sipas dokumenteve ishte e martuar 2 herë, me burrin e parë priftin Pandi Popoviç ka 2 fëmijë. Pandeli Zografi dhe Mario Guernieri, të cilët ishin gjeometër në kënetën e Maliqit. Eugenio Skatu-

rio, i cili kishte detyrën e llogaritarit në Maliq, si edhe Mihal Stratobërdha, Hans Vala, Mirush Përmeti dhe Jani Vasili.

DOSJA ME DËSHMITË E INXHINIERËVE

Ajo që mund të shihet më së shumti nga dosja është se narrativat e përgjithshme e ndjekur nga Sigurimi ishte dhënia e përmasave të gjera ngjarjes, duke e quajtur grupin e inxhinierëve "organizatë tekniko-sabotatore". Gjithashtu, në terminologjinë e përdorur në shkrimin i procesverbaleve nga ana e Sigurimit, vihet re edhe përdorimi i shprehjeve si "tekniko-kriminale", "organizatë agjenturorë", etj, si formë propagande. Një tjetër element i "shpikur" nga Sigurimi për

t'i dhënë grupit karakteristikat e një organizate kriminale është pasja e një simboli dallues ndërmjet tyre, që të bënte të mundur, gjithashtu, marrjen vesh mes tyre dhe agjentëve të UNRRA-s (në dosje përmendet vendosja në krah e një trekëndëshi me një pikë të bardhë në mes).

Të gjitha dëshmitë e të pandehurve, të marra në kushte presioni dhe torturash, përshkruajnë se sabotimi i tharjes së kënetës ishte kryer me qëllim shkaktimin e dëmeve të mëdha ekonomike vendit, për qëllime politike e për llogari të Harry Fultz-it, i cili përpigje të rrezonte regjimin komunist të sapovendosur. Në këto dëshmi të pandehurit përmenden se me urdhër të Harry Fultz-it dhe sipas përgjegjësiwe përkatëse që mbanin në kryerjen e veprës, detyrat sabotuese ishin të ndara ku përkatësisht: "Abdyl Sharra duhet të sabotonte krejt punët në kanal", duke e paraqitur këtë të fundit si organizator të sabotimeve. Ndërsa, "Aleks Vasili duhet të sabotonte në gurorë dhe të ngjallte pakënaqësiira të punëtorët. Eugenio Scaturro do të sabotonte në sektorin e punës së tij duke sjellë pakënaqësiira në mensë, ose duke lënë qëllimisht pa ndrequr një vegël për 2-3 ditë" (marrë nga aprocesverbali i dëshmisë së Vasili

Manos). Edhe dëshmitë e marra nga Kujtim Beqiri, Zyraka Mano, e cila në dosje akuzohet si përgjegjëse për kryerjen e ndërlidhjes e komunikimit ndërmjet grupit të inxhinierëve në Maliq dhe Harry Fultz-it, ripohojnë të njëjtat fakte. Sipas procesverbaleve të mbajtura, janë zhvilluar gjithsej 3 takime midis inxhinierëve dhe të dërguarit e misionit amerikan UNRRA, ku në këmbim të kryerjes së sabotimit, këta të dërguar kanë ofruar shpërblime në sterlina dhe monedha floriri.

AKT - AKUZA

Akt-akuzat e ngritur nga Prokurori vijon si më poshtë:

"Grupi tekniko-sabotator ka kryer (që në verë të 1945):

I. Vepra sabotazhi me stil të gjerë dhe në mënyrë sistematike

II. Vepra spionazhi në favor të agjenteve të huaj

III. Kanë formuar një grup tekniko-profesional për të sabotuar rindërtimin, fuqinë ekonomike të vendit dhe si pasojë për të përmbytur gjendjen e stabilizuar në vendin tonë, në lidhje me monarko-fashistët grekë dhe me reaksionin e jashtëm.

Një tjetër element interesant në dosje lidhet pikërisht me dëshmitë e shkruara dhe të firmosura nga ana e dëshmitarëve që ishin punonjës në Maliq, të cilët akuzojnë grupin e inxhinierëve për sabotim të veprës. Proceset gjyqësorë të të pandehurve filluan në datën 8 nëntor 1946 dhe përfunduan pas 10 ditësh.

QYTETI I PARË E STACIONI I FUNDIT, JORGO BULO "QYTETAR NDERI" I PËRMETIT



Në foto: Akademiku Jorgo Bulo

Dje në Përmet, akademikut Jorgo Bulo i është dhënë titulli "Qytetar nderi" pas vdekjes. Në emër të Akademisë së Shkencave, sekretari Shkencor Vasil Tole, tha se jeta, vepra dhe personaliteti i akademik Jorgo Bulos na nderojnë të gjithë në: familjen Bulo, Akademinë e Shkencave, Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë, Zagorien, Gjirokastrën, Vlorën, Korçën, Shkodrën, Prishtinën e mbarë Kosovën, e shqiptarët kudo janë. Ky nderim që i bëhet nga qyteti i Përmetit, nga qyteti që, si? thoshte vetë Jorgo: "Ishte i pari qytet që pashe dhe vizitova kur isha fëmijë" dhe që u bë edhe stacioni i fundit i jetës së tij, është padyshim më i veçantë ndër të gjitha titujt dhe vlerësimet e shumta që ai ka marrë! "Po cili ishte Jorgo Bulo? Ai është pa dyshim emri më i rëndësishëm dhe përfaqësuesi më i denjë i brezit të dytë të studimeve shqiptare, i atij brezi që u formua nën hijen dhe dijen e E. Çabejt, A. Budës, Dh. S. Shuteriqit, M. Domit, A. Kostallarit", tha Tole. Historian i letërsisë, studiues me interesa të gjera, Jorgo Bulo është prova e gjallë se njeriu i zot ia del të jetë mbi të tjerët edhe kur koha sh-

kon për mbarë, edhe kur koha u vë pengesa të pameritura. "Të gjithë ata që përligjin vetveten se nuk arrijnë të ishin të parët në një kohë të mëhershme, po aq sa dhe ata që ankohen për kohën e sotme, vepra e Jorgo Bulos u thotë: Kjo

është një alibi! Mos e bëni me faj kohën, pyetni veten çfarë ju mungon", - theksoi Tole. Ai vërejtje të Jorgo Bulo nuk ishte orientalist, por u bë orientalist për shkak të Naim Frashërit, ashtu siç Jorgo Bulo nuk ishte gjuhëtar, por u bë gjuhëtar për shkak të përgjegjësisë ndaj shqipes së shkruar dhe njësisë së saj "Jorgo Bulo nuk ishte as filolog, as tekstolog, por u bë filolog e tekstolog për shkak të Mitkos, Çajupit, Shirokës, Asdrenit, Darës dhe poeteve të tjerë të romantizmit dhe post-romantizmit. Nuk arriti të përgatiste një botim të veprës së plotë të Luigj Gurakuqit, të cilin e veçonte prej të tjerësh dhe e çmonte jo vetëm si tribun, por edhe si njeri të letrave, dhe dikush duhet ta çojë deri në fund këtë vullnet të tij. Jorgo Bulo tregoi se metoda nuk mund të jetë kurrë një kufizim për studiuesin" nënvizoi akademik Jorgo Bulo. Sipas tij, pati shumë historianë të letërsisë, edhe të shkencave të

tjera albanologjike, që nuk kapërcyen dot përmbi kufizimet ideologjike të së shkuarës, nuk mund të shndërrohen nga studiues të letërsisë në kontekst në studiet të letërsisë brenda tekstit. Jorgo Bulo dha një përgjigje të qartë dhe të padiskutueshme: Njeriu me formim të shëndetshëm shkencor mund të përdorë për qëllime të mbara edhe komparativizmin, edhe strukturalizmin, edhe semiotikën e semiolingjinë etj. "Ai ka qenë një intelektual aktiv në diskutimet për çështje të rëndësishme shkencore, kulturore e shoqërore të shoqërisë shqiptare në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare dhe në të gjithë veprimtarinë e tij studimore e shoqërore është dalluar për gjykimet të mençura dhe komunikime të ekuilibruara", vërejtje Tole, duke shtuar se "Pas këtij vlerësimi Jorgon e kemi më pranë nesh. Ai do të jetë së bashku me të vetët, me qytetarët e tjerë të ndërtit të Përmetit: Naimin e Samiun, Nonda Bulerin e Odhise Paskalin, me Laver Bariun dhe Rexhep Qosjen e sa e sa të tjerë personalitet të rëndësishme të vendit tonë". Tole falënderoi Bashkinë e Përmetit që e nderonte dhe e nderon personalitetin e madh të vendit tonë, akademik Jorgo Bulo.

LIBRI

Matteo Mandalà

# Mbi identitetin kulturor arbëresh dhe mitet

Ky libër përmbledh e shtjellon rezultatet fillestare të një projekti kërkimor më të gjerë e organik, të miratuar e të mbështetur nga Universiteti i Palermo. Thelbi i temave të rrahura, sikur-se edhe perspektiva e kërkimit në të cilën inkuadrohen ato, ka të bëjë me një studim të strukturuar, të ndërmarrë me synimin për të rindërtuar zanafillën dhe zhvillimin e identitetit kulturor arbëresh. Do saktësuar se ajo çka paraqitet këtu është vetëm pjesa destruuars e projektit. Në të vërtetë, jo vetëm që janë mënjanuar përmes një shqyrtimi kritik falsifikimet në modë të historiografisë arbëreshe, por janë bërë përpjekje për ta vendosur hipotezën e kërkimit brenda atyre caqeve epistemologjike në të cilat, nga njëra anë akribia shkencore i bashkohet gjykimit gjakftohtë, ndërsa, nga ana tjetër, "falsi" (mitik ose historik) individualizohet jo vetëm për t'u dalluar nga "e vërteta", por edhe për t'u peshuar me drejtësi që pastaj të flakët tej përfundimisht. Nuk mund të thuhet se kjo ka qenë një punë e lehtë dhe as mund të mohohet dhimbja e njëmendtë që kam provuar kur vëreja se proceset e ndërtimit të identitetit të kulturave inferiore - siç kanë qenë e ndoshta vazhdojnë të jenë ato të pakicave gjuhësore në Itali - u janë besuar aspekteve më jetëshkurtra të projekteve të mëdha utopike që ideatorët e tyre i kanë hartuar në emër të shpëtimin të bashkësive të tyre prej marginalizimit kulturor e, në rastin e arbëreshëve, edhe të atij social e ekonomik. Ajo që të habit është zbulimi i vetëdijës kund më të vogël e kund më të madhe të mashtrimit, e cila nën formën e detyr-



Në foto: Koptina e librit

*"Arbëreshët nuk janë e vetnja pakicë që është rrekur të falsifikojë historinë"*

së barrës së rëndë të mistifikimeve, do të rivendosin me qetësi e rreptësi shkencore jo aq objektivitëtin (e mëtuar) historik - të cilin, duke ndjekur këshillën e Antonino Butitës (Antonino Buttitta), parapëlqejmë t'ua lëmë histori-anëve të katundit - të procesit të ndërtimit të identitetit me fjalë, sa sistemin ideologjik që e shkaktoi dhe e ushqeu me një program original e të singërtë utopik.

Këtë libër ua kushtoj arbëreshëve, të cilët dua t'i siguroj se ata nuk kanë qenë e vetnja pakicë që është rrekur ta falsifikojë historinë për të fisnikëruar origjinën e vet. Në llogoret e kësaj sipërmarrjeje që më vonë ka dalë e dështuar, janë ngjuar, për shembull, familje të kamura serbokroate të Italisë në kërkim të prejardhjes së tyre të ndritur. Por ajo nuk ka qenë as e fundit. Popuj të mëdhenj e të rëndësishëm evropianë i kanë kërkuar në të shkuarën paraardhësit e tyre të lashtë, dhe kur nuk i kanë gjetur në ndonjë dëshmi të hershme, i kanë sajuar. Mircea Eliade ka përshkruar obsesionin e popujve të Evropës Lindore, të cilët iu drejtuan rindërtimit me të pabesueshme (është domethënës rasti i rumunëve që u shpagan për trazimin e tyre kur i gjetën të legionarët e Trajanit (tamam tek ata që patën pushtuar vendin e tyre) paraardhësit e vet);

imit moral ka mbyllur çdo shteg për t'i shkëputur ato operacione prej harrësës së përhershme me të cilën kanë qenë dënuar e, pra, për të evidentuar, përkundrazi anën tjetër të identitetit, atë pozitive dhe jo të përkohshme, që e dallon si një produkt të vërtetë kulturor.

Me këtë aspekt, tash që u shkëlqoi pakti i gojëkryes historiografike dhe u thyje heshja e shekujve dhe e arkivave, do të merren pjesët e tjera të këtij projekti kërkimor. Bëhet fjalë për ato pjesë të cilat meqë do të realizohen me lehtësi e kënaqësi më të madhe, falë heqjes

për të mos folur pastaj për anglezët e gjermanët që "do të provonin", pak a shumë në të njëjtën periudhë kur arbëreshët nisën spekulime të ngjashme, krejt të pabaza mitologjike, se vinin nga pellazgët hyjnorë të Homerit; ose për skocezët të cilët meqë s'kishin asgjë më të mirë për të dëshmuar madhësinë e tyre kombëtare, shpikën aty nga fundi i shekullit XVIII prejardhjen e tyre nga Highlands, duke e lidhur edhe me simbole të rreme kombëtare, si kilti dhe gajdia, për të mos u ndalur te poemat e rreme epike të Osianit, që do të linin gjurmë të pashlyshme në letërsinë e tjera kombëtare. E kështu mund të rendisim dhjetëra shembuj të tjerë, disa prej të cilëve thjesht zbatimës, disa të tjerë më tragjikë. Sajmët, falsifikimet, rindërtimet e sheqerorura të së shkuarës e kanë shoqëruar historinë e njerëzimit dhe shpesh e kanë përgjakuar atë: mjafton të sjellim ndër mend arsenalin simbolik të diktaturave të mëdha të shekullit XX. E deri këtu nuk ka asgjë të re. Para zbulimeve të këtij lloji hutimi i atij që ka besuar në vërtetësinë e miteve të rrejtshme dhe të simboleve të tyre është i natyrshëm e, madje, i kuptueshëm, veçanërisht kur ushqehet nga ndjenja të singërtë e të pastra. Por meqë ditët e sotme janë të vështira për kulturat e pakicave, nuk mund të vazhdojmë të tregojmë një përrallë duke ia shitur për të vërtetë historike atij që e ka lënë pas fëmijërinë dhe ka arritur pjekurinë e qetësinë e gjykimit. Duke qenë edhe ne jugorë, jemi të lidhur me leksionin e Vikos dhe ka ardhur koha të bëjmë të ditur publikisht se mjetet tona të analizës janë përtërirë fund e krye dhe që nuk kemi më ndërmend të mashtrimit as nga kulturat e bakejeve dhe as nga bakejtë e kulturave, veçanërisht nga ata që duke e ditur se ç'bëjnë, besojnë se mund t'i përjetësojnë gënjeshtrat e tyre.

## DREJTUESIT E KULTURËS KËRKOJNË T'U KTHEHEN PARATË E BILETAVE

Në seancën dëgjimore të mbajtur në Komisionin e Medias, drejtuesit e institucioneve kryesore kombëtare të kulturës në vend kanë kërkuar që të ardhurat nga shitja e biletave t'u kthehen në masën 90 përqind dhe jo 30 përqind sa është e parashikuar në ligj. Zana Çela, drejtore e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit, Hervin Çuli drejtor i Teatrit Kombëtar dhe Ledion Lako, drejtor i Muzeu Arkeologjik Durrës thanë se kthimi i të ardhurave do t'i bënte më të pavarur nga fondet buxhetore. Edhe këtë vit, Ministria e Kulturës ka pasur pak rritje në buxhet, por, siç shihej edhe nga projekt-buxheti që prezantoi Ministria e Kulturës Mirela Kumbaro, rritja është e papërfillshme dhe pos kësaj, në atë fond, nuk janë parashikuar rritjet e rrogave për disa kategori, që i kushtojnë buxhetit një shumë të konsiderueshme. Kumbaro bëri me dije se nga trashëgimia dhe arti: të ardhurat në vitin 2013 kanë qenë 61 milionë lekë ndërsa në vitin 2017 149 milionë lekë. E megjithatë, "Ministria e Kulturës përballlet me një problem në përdorimin e këtyre të ardhurave nga ana institucioneve të varësishme, pasi tavanet që na vendosen nga Ministria e Financave, janë kundrejt të ardhurave të vitit 2013, ndërkohë që të ardhurat tona nga sektori i biletarisë janë rritur ndjeshëm që nga 2013". Në vijim të ankesës, thuhet se sikurse edhe në kërkesat e mëparshme, "Kërkojmë si ministri të rregullohet kjo anomali duke na u rritur tavanit buxhetor për shpenzimet korrente sipas udhëzimit të përbashkët të të dyja ministrive të Financës dhe të Kulturës të vitit 2015, për përdorimin e biletave". Sipas Kumbaros, për buxhetin e vogël të Ministrisë së Kulturës, kjo nuk është një shumë e pakonsiderueshme, por bëhet fjalë për rreth 26,6 milionë lekë nga të cilat në programin e trashëgimisë 22,4 milionë lekë dhe në programin e Art&Kulturë 4,2 milionë lekë, shuma me të cilat Ministria e Kulturës ka për objektivat të ndërhyjë në mirëmbajtjen e këtyre objekteve dhe në përmirësimin e shërbimeve dhe të produksioneve artistike, në mënyrë që të gjenerojnë të ardhura akoma më të mëdha në vijim.

## "NGJYRAT E SHQIPËRISË", ÇELET EKSPOZITA ME FOTOT MBRESËLËNËSE



Ekspozita "Ngjyrat e Shqipërisë", me punimet më të mira që promovojnë

peizazhet e paprekura, si dhe portretet e realitetin shqiptar. Mbi 23 mijë foto u bënë pjesë e garës, me pamje që ia vlejnë të rrefëhen dhe i japin vlerë vendit. Element i genësisë në tyre është tradita, zbulimi e rizbulimi i Shqipërisë, pa objektivitëtin të dëgjuesit e jeton atë. Në këtë kuadër, fotot më të arrira prezantohen në një ekspozitë të posaçme në mjediset e bibliotekës së COD. Pamjet fituese do të jenë pjesë e albumit

që do t'u shpërndahet të gjitha përfaqësive shqiptare nëpër botë dhe do të përdoret si dhuratë simbol i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme. Prezantimi i ekspozitës u ndoq nga bashkëbisedimi me të ftuarit e ministrit Bushati, bisedë e fokusuar në qëllimin dhe rezultatet e nismave të tilla, që i japin formë imazhit të Shqipërisë në botë. Pa objektivitëtin janë njerëzit e zakonshëm, kryesisht të rinjtë, e që talentin dhe kontributin e tyre mund të shërbejnë si ambasadorë të Shqipërisë. Është arritur që përmes imazheve, si forma lehtësisht të perceptueshme nga publiku, të përcillen denjësisht vlerat dhe traditat vendase. Dhe më shumë se të tregohet me një fotografi, është synuar të nxitet reflektimi apo të adresohet një realitet që i duhet kushtuar vëmendje. Më herët, promovimit të Shqipërisë online i janë bashkuar figura si Lorik Cana, Kombëtarja Shqiptare, Ermonela Jahja, Saimir Pirgu, Kledi Kadu e shqiptarët tjerë të mirënjohur në botë.



Opinioni *i* Ditës

Nga dr. Jorgji KOTE

(Vijon nga faqja e parë)

# Tërmet politik dhe për Evropën

... për krijimin e qeverisë së re, para dy ditësh, ishte një tërmet i vërtetë politik shumëballësh. Sepse kjo ndodhi për herë të parë në këto 70 vitet e fundit në këtë vend, duke shfaqur kësajosi, po për herë të parë, shenja të paaftësisë për krijimin e një qeverie funksionale. Sepse do të ishte hera e parë në gjithë historinë moderne gjermane që do të krijohet një koalicion i tillë, i vështirë, i ashtuquajtur "Xhamaika", nisur nga ngjyrimet e katër partive pjesëmarrëse në këto bisedime; më tej, mendohej se kjo aleancë do të ishte përgjigja dhe alternativa më e mirë ndaj forcave populiste dhe ekstremiste të majta dhe të djathta e sidomos ndaj Alternativës për Gjermaninë (AfD), që, dhe ajo për herë të parë pas 70 vitesh, u fut në Bundestag, si partia e tretë më e madhe gjermane me 98 deputetë. "Xhamaika" mendohej si një aleancë e vështirë, por premtuese e të mesmes qytetare gjermane; ajo do të bashkonte konservatorët tradicionalë të CDU/CSU, që kanë qeverisur vendin për dekada me liderë emblematikë si Adenauer dhe Kohl, liberalët partizanë të tregut radikal që kanë qënë shumicën dërmuese të kohës në koalicionet historike me të majtën dhe të djathtën dhe me figura të shquara si ish-Presidenti Walter Scheel dhe ministri i Jashtëm legjendar Dietrich Genscher dhe të Gjelbërit e majtë, 12 vjet pas daljes nga pushteti në koalicion me social-demokratët gjermanë. Ky koalicion do të kishte në krye Kancelaren Merkel, me një përvojë ta lakmueshme 12 vjeçare si Kancelare, me imazh të madh ndërkombëtar dhe garanti kryesor i stabilitetit politik dhe paqes sociale në vend. Merkel bëri çmos për ngjizjen e këtij koalicioni, sepse, veç të tjerash, ajo ishte më e interesuara që të lihej pas jo e këndshme e 24 shtatorit dhe të bëhej përpara me axhendën gjermane e më gjere.

Për pasojë, tashmë politikës gjermane do t'i duhet të zgjidhë një rebus të ngatërruar e të koklavitur politik me tri apo katër variante/mundësi gjithsesi njëra më problematike se tjetra.

Alternativa më e dëshirueshme është rikthimi i mundshëm i liberalëve në tryezën e bisedimeve, sidomos pas ftesës dhe bisedimeve të djeshme me Presidentin e Republikës gjermane Walter Steinmeier.

Mundësia e dytë më e mirë është pranimi i social - demokrateve për të anuluar vendimin e tyre të mëparshëm për kalimin në opozitë pas rezultati katastrofal në zgjedhjet e 24 shtatorit dhe për t'u ribashkuar sërish me Merkel në koalicionin e madh; siç kanë vepruar në vitin 2005 dhe gjatë mandatit të kaluar; lideri i tyre, ish-kandidati për Kancelar Martin Schulz e ka refuzuar deri tani një mundësi të tillë, sepse sipas tij elektorati ua ka hequr këtë mandat dy partive të mëdha, që, në fakt, është tezh shumë e diskutueshme. Madje, ai parapëlqen variantin e zgjedhjeve të reja, edhe pse sipas ekspertëve

dhe politikanëve, SPD-ja e tij s'është duket se nuk ka shanse më të mira se më 24 Shtator dhe as kandidat më të mirë. Në median dhe politikën gjermane qysh tani ka filluar të kritikohet ky pozicion i cektë partiak i ish-Presidentit të Parlamentit Evropian. Në fakt, në gjendjen e krijuar, kur kërkohet përgjegjësi historike për fatet e gjithë vendit e jo të një partie, vazhdimi i koalicionit me CDU/CSU do

qeverisë ; sipas nenit 68 të Kushtetutës gjermane, këto zgjedhje mund të bëhen pak a shumë diku nga fundi i janarit ose në shkurt 2018. Mirëpo kjo alternativë është e mbarsur me të papritura dhe enigma ndoshta dhe më të mëdha, si për rezultatet e zgjedhjeve, ashtu dhe për fatin e mëtejshëm të krijimit të një qeverie funksionale. Për pasojë, ky proces do të mund të përfundonte, në rast se gjithçka

parë të vitit 2018 me programe dhe samite tejet të rëndësishme. Mirëpo zhvillimi, dhe ca më pak sukcesi i tyre, nuk mund të mendohet kurrsesi pa kontributin gjerman dhe lidhshimin e Kancelares Merkel, që me gjithë rënien e popullaritetit, mbetet liderja më e besueshme dhe e fuqishme në Gjermani dhe në Evropë. Mirëpo, kjo e fundit ka dy muaj që është dhe mund të vazhdojë të drejtojë dhe



të ishte dhe për vetë SPD-në një rast i volitshëm për të rigjeneruar veten e saj në praktikën qeverisëse dhe rritjen e besueshmërisë së saj elektorale.

Në pamundësi, mbetet krijimi i një qeverie të pakicës si një mundësi teorike, por aspak praktike për Gjermaninë. Vetë Merkel është shprehur hapur kundër këtij varianti. Ndryshe nga disa vende të vogla dhe me përvojë në këtë drejtim, qeveria e pakicës nuk mund të funksionojë në një vend të madh federal si Gjermania dhe me rol të gjerë ndërkombëtar; nga ana praktike, imagjinioni për një çast Merkel të detyruar që për çdo vendim të rëndësishëm të strapacohet te të gjithë krahet politikë për të siguruar shumicën e nevojshme për miratimin e tyre; ndërkohë, rreziku i rrëzimit të asaj qeverie do t'i qëndronte asaj te koka si "Shpata e Demokleut". Veç kësaj, AfD-ja dhe forca të tjera politike do të shfrytëzonin qeverinë e pakicës dhe debatet parlamentare për të ndezur dhe radikalizuar situatat, çka do të çonte paqëndrueshmëri në mullirin" e tyre ekstremist.

Në pamundësi të alternativave të lartpërmendura mbetet zhvillimi i zgjedhjeve të reja të përgjithshme brenda 60 ditëve pas rënies së

do të ecte normalisht në prag të stinës së verës; tepër, tepër vonë dhe me pasojë të shumta serioze politike, ekonomike dhe financiare për Gjermaninë, imazhin e saj në botë, etj.

Por kjo është vetëm gjysma e të keqes. Të gjithë ekspertët dhe analistët politikë janë të mendimit se tërmet politik gjerman do të jetë me shumë efekte negative edhe në institucionet dhe vendet e tjera antare të BE-së. Sepse Gjermania është vendi më i madh evropian, me kontribut vendimtar në të gjitha fushat dhe bashkë me Francën boshti dhe motori i BE-së.

Siç u përmend dhe më lart, varianti i zgjedhjeve të reja, pavarësisht rezultatit të tyre, do të ishte tejet i dëmshëm për reformat për fatet e rinovimit të BE-së, mbi bazën e platformës së Presidentit francez Macron dhe reformës së languar nga Presidenti i Komisionit Evropian Juncker. BE ka kohë që është në pritje të pranisë dhe ndihmesës gjermane në këto fusha jetike për ekzistencën e BE-së. Aq më tepër kur pas vonësës së shkakuar dhe nga zgjedhjet e këtij viti në Francë, Austri, Holandë dhe gjetkë, axhenda evropiane është tejet e ngjeshur; duke filluar nga muaji dhjetor dhe në gjysmën e

për disa muaj të tjerë vendin, tashmë, vetëm si e ngarkuar me detyrën e Kancelares me një qeveri me tepër kujdestare dhe me mandat të kufizuar.

Këto pasojë dhe efekte negative pritet të shtrihen dhe në rajonin tonë. Gjermania dhe Kancelarja Merkel njihen tashmë si promotorët dhe avokatë të fuqishëm të proceseve integruarë në vendet tona dhe të Shqipërisë. Mjafton të përmendim Procesin e Berlinit që madje është kërkuar të plotësohet më tej si "Berlin plus" dhe mbështetja e saj për çeljen e negociatave të anëtarësimit me BE-në. Në këtë kuadër, në muajin maj është planifikuar të zhvillohet dhe një samit i posaçëm kushtuar vizioneve të reja integruarë të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Mirëpo gjendjen e krijuar, s'është fjala dhe pesha politike gjermane do të jenë të kufizuara.

Ndaj, të gjithë në Gjermani, në Evropë dhe më gjerë, e së bashku me ta dhe ne në Shqipëri, shpresojmë shumë që kriza gjermane të zgjidhet sa më shpejt, që Gjermania të vazhdojë të mbetet lokomotivë e ekonomisë, model dhe kampione e demokracisë, paqes dhe stabilitetit politik/institucional në Evropë dhe në botë.

## HOROSKOPI

### DASHI

Të humbësh një mundësi të mirë nuk është e këndshme, por tani mos e dramatozoni. Kërkoni të tjera, ndoshta edhe më të mira, kështu do të keni diçka për t'u ngushëlluar. Mos u dekurajoni përballë dyshimeve të ndokujt. Nevojitet kohë për t'ia dalë që ta bindni.

### DEMI

Pozicionimi i Diellit dhe Hënës mund të jetë mundësia e duhur për të menduar rreth asaj gjëje që doni më të vërtetë, duke braktisur drejtimet që nuk sjellin gjë. Një përpjekje fizike e tepërt mund të t'u krijojë shqetësimet. Prandaj merruni me sport, por me masë.

### BINJAKET

Keni përjashtuar një person pa u menduar shumë, por tani duhet të ndërgjithësoni situatën, duke qënë se e keni kuptuar si është puna. Ju takon të bëni një hap mbarrap. T'u rikthoheni gjërave është një lëvizje e zgjuar, kur e keni kuptuar se keni gabuar. Më mirë vonë se kurrë!

### GAFORJA

Projektet më të rëndësishme fillojnë mbarë, edhe falë pozicionit të Marsit me shenjen e juaj si edhe mundësi që keni për t'i shuar talentet që keni. Nuk keni probleme t'u tregoni të tjerëve se keni të drejtë, ja pse do t'ju ndjekin pa u shqortuar.

### LUANI

Nervozizmi i juaj i bashkohet dhe paqëndrueshmërisë së juaj, duke krijuar një miks shpërthyes. Më mirë të gjeni zgjidhje dhe të mos kërkoni më shumë probleme. Nëse nuk do të keni shumë punë, do të keni kohë për të bërë pazar e për të blerë gjëra që ju pëlqejnë, pse jo së bashku me një partner!

### VIRGJERESHA

Puna e mërzitshme mund të presë, sot për ju vetëm argëtim dhe hobi të shëndetshme dhe të këndshme. Kështu mund të kaloni kohën duke piktuar, apo edhe pas sobës, duke përgatitur ushqime të shijshme!

### PESHORJA

Për të hequr ndonjë mendim jo shumë pozitiv, mendoni për çdo gjë të bukur në jetën e juaj. Menjëherë do ta kuptoni se jeni shumë me fat! Të ndryshosh nuk është e gabuar, por para se të veproni duhet të keni në mendje në projekt shumë të qartë.

### AKREPI

Pozicionimi i Hënës ju pengon, por ardhja e Marsit të Dashi nuk mund të mos ndodhte në një moment më të mirë, për ju. Do të tejkaloni çdo lloj pengese. Nëse një çështje po ndërlikon ekzistencën prej disa kohësh, tani me në fund gjithçka zhblikohet.

### SHIGJETARI

Nëse ke zvarritur për në fund detyrat më të mërzitshme, tani duhet të bëni përmirësime. Lërimi mënjantë projektet fantastike, që nuk kanë lidhje me realitetin: kthehuni me këmbë në tokë.

### BRICJAPI

Një shëtitje jashtë shtëpisë është ajo që ju duhet për t'u shpërtuar nga rutina e përditshme e ndoshta edhe për të vizituar vende të reja dhe interesante. Keni nevojë të ushqeni fantazinë tuaj, dhe leximi i një libri të mirë mund të jetë ajo për të cilën keni nevojë.

### UJORI

Jeni të shpërgjendur disa, por fatmirësisht qetësia e kësaj dite do t'i fshesë mirë dobësitë e juaja. Nuk do të keni probleme. Nëse nuk e dini diçka, mos bëni sikur e dini. Më mirë të thashë menjëherë të vërtetën, për të shmangur gjera të pakëndshme.

### PESHQIT

Ngjarje të rëndësishme të lidhura me punën, janë bërë më urgjente me ardhjen e Marsit te kjo shenjë, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e jetës në çift. Nuk do të jetë e lehtë të gjeni në një ekulibër midis jetës private dhe profesionale, por ju do t'ia dini.

Opinion i Ditës

# Dita e Alfabetit shqip, moment përbashkues i kombit

Nga Ilir Meta

... historianësh, albanologësh, përfaqësues nga të gjitha trevat shqiptare.

Njëqind e nëntë vjet më parë, në qytetin e vjetër të Manastirit, përfaqësuesit më të spikatur e të mençur të Rilindjes sonë Kombëtare dhe veprimtarë të shquar, të deleguar nga shoqata të ndryshme kulturore dhe atdhetare, të mbledhur në Kongresin e Manastirit, i dhanë zgjidhje një problemi madhor të kulturës kombëtare, Alfabetit të Gjuhës Shqipe.

22 Nëntori, Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, është padyshim një nga datat më të mëdha të historisë sonë kombëtare, momenti kyç e përbashkues, që e orientoi kombin tonë drejt kombeve të përparura të botës perëndimore.

Pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që shënoi pikën më kulmore të organizimit politik dhe ushtarak për mbrojtjen e intereseve kombëtare, Kongresi i Manastirit shënohet si ngjarja më e madhe historike e kombit tonë që do t'i paraprinte shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në 28 Nëntor 1912.

Kongresi i Manastirit vlerësohet me të drejtë për rëndësinë e tij politike e kulturore, por dy janë arritjet më kryesore të tij, akti historik i institucionalizimit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe dhe përgafimi i modelit të alfabetit perëndimor, alfabetit latin.

Ndaj edhe sot, pas njëqind e nëntë vjetësh, ne shqiptarët duhet të jemi krenarë për vendimet e Kongresit të Manastirit, kryeqytetit të alfabetit shqip, i cili e renditi gjuhën e lashtë shqipe në radhët e gjuhëve moderne.

Kongresi i Manastirit pati rëndësi të madhe jo vetëm për alfabetin dhe për gjuhën letrare kombëtare, për arsimin e për kulturën, por edhe për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në përgjithësi.



36 shkronjat e alfabetit tonë përjetësuan shkrimin shqip dhe historinë e shqiptarëve në trojet ku

ata historikisht kanë jetuar dhe do të jetojnë.

Me alfabetin e Kongresit të Ma-

nastirit u shkrua dokumenti i Pavarësisë së Shqipërisë në 28 Nëntor 1912.

Me këtë alfabet u nënshkrua edhe Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008.

Me këtë alfabet u shkrua në shqip edhe Marrëveshja e Ohrit e 13 gushtit 2001. Me këtë alfabet shkruhet edhe liria dhe mbrojtja e respektimi i të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni.

Me këtë alfabet u hartua edhe Kushtetuta e Shqipërisë dhe neni për mbrojtjen e shqiptarëve kudo ata ndodhen, por edhe traktatet e miqësisë mes vendet fqinje.

Me këtë alfabet, ne shqiptarët do të shkruajmë edhe ardhmërinë e sigurt e të plotë të të gjithë shqiptarëve. Ky është thesari më i çmuar dhe trashëgimia më e rëndësishme që të parët tanë e fituan me shumë mundim dhe në kohë të vështira për kombin tonë.

Jam shumë i gëzuar që godina historike e Kongresit të Manastirit, që unë sa e vizitova, do t'i nënshtrohet restaurimit dhe do t'i rikthehet rëndësia e saj historike dhe muzeale e shpresoj shumë që ky monument të kthehet në një vend pelegrinazhi për ne, veçanërisht për fëmijët tanë, të cilëve duhet t'u mësojë më shumë për historinë tonë dhe t'u ushqejmë dashurinë për atdheun, kombin dhe gjuhën tonë amtare.

Na takon të gjithëve të jemi shumë të përkushtuar dhe të vëmendshëm, të ruajmë këtë trashëgimi e ta përcjellim në brezat që vijnë, sepse nëpërmjet gjuhës sonë të dashur përcjellim historinë, kulturën, traditën, simbolat, vlerat mes nesh, por edhe ndaj të tjerëve.

Gjuha është e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e një kombi, shlylla kurrizore e tij, tipari unik dhe identifikues i tij.

Sukseset në punimet e këtij simpoziumi!

Ju faleminderit!

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE  
MOBILE DHE TABLET


KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE  
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ





**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Mund të jetë një arkë.
8. Fillojnë ndeshjen
9. Paul që këndonj Diana.
10. Spanja që këndonën En Itali.
13. Fillojnë lojën.
14. Gjysmë tepsie
17. Mund të jenë ekspres.
18. Qe babai i mjekësisë.
21. Eshhtë si ballon.
22. Lind një në kokë.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Një pjesë e edukatës.
27. Inicialet e Asimov.
28. Eshhtë e vrara në kuffët.
30. Iglu te Lazio.
31. Inicialet e Redford.
33. Mbetet në fund.
34. Pak analogji.
35. Eshhtë vdekje e autorizuar.

**VERTIKAL**

1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një...FIAT.
3. Mbyllin një hark.
4. Eshhtë si sarkazmë.
5. Fillojnë ideologjinë.
6. Ushtrohet me cd false.
7. Në këtë moment.
8. King Cole i muzikës.
11. Janë si cilësi.
12. Fillojnë nazet.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. Janë binarët.
18. Nënkuptonjë edhe pranga.
19. Aktet pa kufij.
20. I takojnë fituesit.
21. Quinn aktor.
22. Pak inekzistente.
23. Fillojnë dobët.
24. Rrjeshtohen në kuvertë.
29. Eshhtë divorci.
32. Një pije piratësh.
33. Zanore për perime.
36. Një peshk i rëndë.
37. Enti amerikan i hapësirës.
38. Yll anglez.
40. Gripi paa ekstreme.
41. Tiran pa kufij.
46. Në hyrje të oazit.
48. Fillojnë ilustrimet.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Marple a Agatha Christie.
4. Zanore për zulu.
6. Qyteti i Protogora-s.
11. Inicialet e Lendl ish tenist.
12. Janë tek në kufij.
14. Benigni aktor.
16. Mund të jetë me mbret.
18. Gjysmë ndikim.
20. Një dru aromatik.
21. Teke trari.
23. Janë me numër të tilla ushtarake.
24. Nusja pa cifte.
25. Iglu te Lazio.
26. Një pjesë e sipërfaqes.
27. Një fjalë... para kohe
28. Janë mashtrime... me grim.
31. Duken të gjata në pritje.
32. Skuadra merengue.
33. Eshhtë trofe sportiv.

**VERTIKAL**


15. Një britim në corrida.
16. Një gjellë gratis.
17. Rolet pa zël.
19. Eshhtë e hollë dhe therëse.
20. Një brejtës pylli.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për gol.
27. Janë maskarenj.
28. Tre në tetëdhjetë.
29. Emri i parë i Fassbinder.
30. Fillojnë turnin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë Organoziata e skuadrave të Formula 1.
35. Mbyllin punimet.
37. Ndoch në kufij.
38. Një pëlthurë.
40. Pak tradicionale.
41. Një cigan.
43. Fillojnë lehtë.
45. Mbyllin një manastir.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

3				2	7		8
	7	1			8		
		6		9	3		1 2
9			6			5	4
	8		2		7		6
	4	7			5		1
4	3		8	1		2	
			5			6	9
5		2	3				4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	8	2	5	9	7	6	4	3
7	3	9	4	2	6	8	5	1
5	4	6	1	3	8	2	9	7
3	6	1	2	8	5	9	7	4
9	2	5	7	4	1	3	6	8
8	7	4	9	6	3	1	2	5
2	1	7	8	5	9	4	3	6
6	9	8	3	7	4	5	1	2
4	5	3	6	1	2	7	8	9

*Argëtim filozofik*

- Dikush, duke mos qenë në gjëndje të arrijë sukses në këtë botë, hakmerret duke folur keq për të. (Volter)
- Nuk ka vlerë të thoni "ne po bëjmë më të mirën që mundemi". Sukses arrihet duke bërë atë që është e nevojshme. (Uinston Curcill)
- Nuk mund t'ju jap formulën e suksesit por mund t'ju jap formulën se si mund të dështoni: përpiqini të kënaqni çdo njëri. (Herbert Bajard Suop)

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	19	5	6	4	6	6	1	4	1	7		
1	15		11	8	8	6	5	L	I	M	A	
17		14	8	5	8	12	1	7	8	7	5	
	6	3	7	9	6	1	13	8	7	14	8	
17	9	6	19	13	3	7	3	7	3	7	13	
9	16	8	15	1	7	9	15	8	7	7	7	
										12	1	
16		4	13	13	3	6	1	5	5	3		
1	6	3	1	13	7	17			9	4	8	
13		9	7		8	17	3	16	9	15	8	
3	7	13		8	7	3	5	8	13	3	8	
17	15	3	6	3		4	3	15	7	1	17	3

S	T	R	I	P	B	B	V	O	T	A	
H	E	R	O	I	N	A	O	V	E	R	
S	A	S	S	N	R	V	R	T			
U	T	S	H	T	E	T	E	R	O	R	
B	L	I	T	E	R	A	T	U	R	A	T
M	I	N	E	R	A	L	E	T	C		
K	A	L	O	R	E	S	I	T	H	A	V
C	A	R	I	S	T	I	N	T	L		
V	H	I	M	I	M	I	K	E			
R	A	M	E	T	N	A	A	R			
A	D	R	E	S	E	I	T	A	L	I	A
P	O	L	E	M	I	K	A	S	E	A	T

*Thënie të mënçura*

- I dua njerëzit që kanë mbetur në jetën time, ma bënë jetën të mrekullueshme, i falënderoj edhe njerëzit që u larguan nga jeta ime, ma bënë jetën fantastike...
- Në botë ka njerëz që kanë para... dhe njerëz që janë të pasur...
- Ne nuk jetojmë, thjesht shpresojmë të jetojmë, duke pritur gjithnjë lumturinë në të ardhmen, ndaj është e pashmangshme që s'do të jemi asnjëherë të lumtur. (Blez Paskal)
- Bota është një anije mbi të cilën jemi të gjithë pasagjerë: nuk duhet të lejojmë që ajo të mbytet. (Mikhail Gorbaçov)

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

M	A	T	A	H	E	L	M	E	T			
A	R	R	A	L	E	L	E	T	L	E	R	
P	A	R	A	L	E	L	E	T	L	E	R	
P	O	L	I	F	E	M	I	O	L	E		
E	M	I	L	E	Z	O	L	A	E	T	I	K
L	A	I	R	A	E	R	E	Z	E			
E	R	A	I	B	E	M	R	I	I	S		
H	I	M	A	E	S	T	R	O	D	E		
T	A	L	E	N	T	E	T	A	R	T	A	
E	K	R	A	H	O	R	A	R	T	A		
S	I	P	R	I	T	I	A	T	A			
K	A	P	A	N	O	N	E	T	L	A	L	A

**FJALËKRYQI (2)**

D	I	S	K	O	T	E	K	A	T	A	P	
R	O	M	A	N	A	R	G	O	S	A	A	
E	N	T	G	N	I	R	H	R				
W	M	O	N	O	G	R	A	F	I	A	A	
P	E	L	E	G	R	I	N	A	Z	H	E	T
P	O	L	I	G	L	O	T	E	T	I	D	E
A	L	K	R	A	H	E	T	K	S	H		
K	E	N	I	T	T	K	A	T	E	T		
E	M	I	L	E	S	T	J	O	M	E	R	
T	I	M	E	R	E	N	T	A	R	T	I	
A	K	S	E	R	I	O	Z	N	A	R	A	M
T	E	O	T	R	A	Z	J	A	R	R	I	

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

